9. Nxënësit në përgjegjësinë e vet, mund të botojnë gazetë për nxënësit. Në këtë rast, duhet të kihet kujdes për "Direktivën për botimin e gazetës për nxënësit në gjimnaz".

## B. MËSIMI

1. Mësimi, orientohet në planet mësimore në fuqi dhe direktivat për shkollat publike të Kosovës, si dhe në vendimet e organeve profesionale. Në këto suaza, kanë hapësirë të lirë iniciativat pedagogjike të mësuesit dhe aktivitetet dhe interesat e nxënësve.
2. Orët e mësimit fillojnë dhe mbarojnë saktësisht në kohën e caktuar. Mësuesit dhe nxënësit, përshëndeten në fillim të mësimit.
3. Zëvendësimet lajmërohen në mënyrë obliguese, përmes shpalljes në vend të caktuar për shpalljen e njoftimeve. Në rast se ndonjë mësues vonohet më tepër se 5 minuta, zëdhënësi i klasës, respektivisht ndonjë përfaqësues i klasës, do të kërkojë informatë në dhomën e mësimit ose në drejtorinë e shkollës mbi mënyrën e rregullimit të mësimit.
4. Të gjithë nxënësit dhe mësuesit, kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në lokalet shkollore. Dëmtimet dhe ndotjet dhe shkaktri i dëmit, duhet t'i paraqiten menjëherë kujdestarit të klasës. Kujdestari do të ndërmerr masat për të gjetur ndihmë. Për dëmtimet e qëllimshme, për dëmin përgjigjen autorët, respektivisht prindërit e tyre. Në lokalet profesionale, parimisht, nxënësit qëndrojnë vetëm në prezencën e mësimdhënësve. Në terrene dhe salla sportive gjithëashtu, mund të hyhet vetëm nën mbikëqyrjen e mësuesit përgjegjës, duke pasur parasysh rregullat në fuqi mbi shfrytëzimin e tyre.
5. Ndërrimi e veshjes, para dhe pas orës së kulturës fizike, bëhet në lokalet e parapara për këtë. Orët e sportit (kulturës fizike), përfundojnë me kohë para fillimit të pushimit, kështu që mbetet kohë e mjaftueshme për ndërrim të veshjes dhe bërjen e dushit.
6. Detyrat e shtëpisë janë në lidhje të ngushtë me mësimin. Detyrat jepen në atë mënyrë që nxënësit ato mund t'i kryejnë pa ndihmë nga të tjerët dhe në një kohë të përshtatshme si dhe duke pasur parasysh kërkesat e lëndëve tjera. Ato kumtohen në kohë të duhur, para mbarimit të orës dhe shënohen nga nxënësit. Nxënësit e të gjitha klasëve, mbajnë fletore të detyrave. Në rast të konfliktit, kujdeset kujdestari i klasës për harmonizimin kohor të detyrave të shtëpisë nga lëndët e veçanta dhe do ta ketë parasysh respektimin e rregullave ekzistuese: nga e shtuna për të hënë, gjatë festave dhe kohës së pushimeve, nuk jepen kurrfarë detyrash. Në lëndët dhe rastet në të cilat përndryshe nuk mund të arrihet një përparim i arsyeshëm, përjashtimet janë të mundshme.
7. Pushimet gjatë kohës shkollore, mund të jepen vetëm në raste të arsyeshme. Për orët e veçanta, lejen mund ta jep mësuesi i lëndës, për më shumë orë – deri në një ditë shkollore (e hënë deri në të premten) – kujdestari i klasës/tutori, për të shtune dhe më shumë ditë shkollore-drejtori i shkollës. Ditëve të udhëtimit, pushim mund të

jepet vetëm nga drejtori i shkollës, gjithashtu në rast të udhëtimit në vendlindje për pushime mund të lejohet një shkuarje e mëhershme ose kthim i mëvonshëm. Pushimet e të shtunave dhe të më shumë ditëve shkollore, sidomos para pushimeve, duhet të kërkohen te drejtori i shkollës me shkrim nga prindërit, së paku 8 ditë para afatit të dëshiruar.

8. Lirimi nga pjesëmarrja aktive në kulturën fizike (sportive) (edhe nga ndonjë ushtrim i veçantë) për një kohë më të gjatë, mund të bëhet nga mësuesi i lëndës në marrëveshje me drejtorinë e shkollës vetëm pas prezantimit të çertifikatës mjekësore. Për klasat 12 dhe 13, vlen: Kërkesa për lirim të pjesshëm ose afatgjatë nga pjesëmarrja aktive në mësimin e kulturës fizike. Ajo, i parashtrohet drejtorisë së shkollës, menjëherë pas mësimit për shkakun e pengesës, duke ia bashkangjitur edhe çertifikatën mjekësore. Në këtë rast, mund të kërkohet ekzaminimi nga mjeku zyrtar. Nxënësit e të gjitha klasave, të cilët janë të liruar nga pjesëmarrja aktive në mësimin e kulturës fizike, gjatë orëve të kulturës fizike mbesin me klasën e vet. Ata, pra, gjenden nën mbikëqyrjen e mësuesit të kulturës fizike. Nxënësit e klasës 11, duhet të arrijnë një rregullim të veçantë me mësuesin e kulturës fizike.
9. Në qoftë se ndonjë nxënës për shkak të sëmundjes ose arsyeve të rënda, nuk mund të merr pjesë në mësim, atëherë ai për këtë, më së voni deri në orën 8.00, duhet të lajmërojë sekretariatën e shkollës, ose portën. Me rastin e kthimit në mësim, ai duhet të prezantojë dëshminë me shkrim të ndonjë enti shëndetësor ose të autorizuarit për edukim, nga e cila shihet kohëzgjatja dhe arsyeja e mungesës. Nxënësit e moshës madhore arsyetohen vet. Nxënësit e shkollës, mbajnë librin e shfajësimit. Në rast të mungesave më tepër se 3 ditë, në rastet e mungimit më të shpeshtë brenda një kohe të shkurtër ose moskryerja e një pune të klasës, mund të kërkohet çertifikata e mjekut. Shfajësimet e dyshimta, mund të refuzohen, në qoftë se ato nuk përmbajnë asnjë arsye të qëlluar, ose arsyeja e qëlluar e dhënë nuk mund të dëshmohet. Mungesa e paarsyeshme parimisht shpjen deri te qortimi.
10. Nxënësi duhet të caktojë terminin mjekësor, jashtë orarit të mësimit.
11. Nxënësit që mungojnë, do të shënohen në ditarin e klasës nga mësuesi i lëndës. Paraqitjen e arsyetimit, e vërteton kujdestari i klasës me vërejtje, duke shënuar emrin në ditarin e klasës. Nxënësi i cili paraqet arsyetimin do të kujdeset që kjo vërejtje edhe të regjistrohet.

### C. PUSHIMET DHE ORËT E LIRA

Pushimet i shërbejnë çlodhjes dhe përgatitjes për orën e ardhshme mësimore. Për të siguruar këto qëllime dhe për të arritur një mbikëqyrje të përshtatshme, vlejnë këto rregulla:

1. Në pushimet e shkurta, nxënësit qëndrojnë në suazat e lokaleve të klasës ose shkojnë rrugës më të shkurtër në lokalet e kabineteve profesionale. Përgjegjësi për klasën

ose nxënësi i caktuar nga kujdestari i klasës (p.sh. komisarët për kursimin e energjisë), përkujdesen për ajrosjen e mjaftueshme të dhomës së mësimit. Me rastin e daljes, ata i mbyllin të gjitha dritaret dhe i shuajnë dritat.

2. Në fillimin e pushimit të gjatë, të gjithë nxënësit lëshojnë dhomat e mësimit dhe kabinetet. Për shkak të detyrës së mbikëqyrjes, nxënësit qëndrojnë vetëm në hapësirat e caktuara për këtë.
3. Mësuesit në fillim të pushimit të madh, i mbyllin dhomat e mësimit.
4. Vrapimet, lojërat me top dhe të ngjashme në ndërtesë nuk janë të lejuara për shkaqe sigurie.
5. Shkeljet e rendit të pushimit, do të ndëshkohen me qortim.
6. Në orët e lira, nxënësit mbesin në dhomat e tyre të mësimit. Këtyre nxënësve, u ndalohe vizita e lokaleve të konviktit, gjatë kohës së mësimit. Gjatë orës së lirë, nxënësit rrinë të qetë në dhomën e tyre të mësimit, kështu që ndonjë angazhim tjetër, mund të jetë kuptimplotë dhe nuk do të pengohet mësimi në dhomat fqinje të mësimit.
7. Gjatë kohës së mësimit, nuk lejohet qëndrimi në hyrje ose loja në oborrin e pushimeve si dhe në amfiteatër.
8. Nxënësit e jashtëm, që janë të obliguar të jenë në kolegji pasdite, duhet të qëndrojnë në lokalet e caktuara për këtë. Aty mbretëron qetësia, për të shfrytëzuar kohën në mënyrë kuptimplotë. Nxënësit, janë përgjegjës për atë që lokalin që e kanë shfrytëzuar, ta lënë në gjendje të rregulltë. Dritaret, duhet patjetër të mbyllën, dhe dritat të shuhën. Ngjarjet e veçanta, duhet të paraqiten pa vonesë në drejtorinë e shkollës.
9. Mbikëqyrja në kohën e orëve të lira, është obligim i shkollës. Të gjithë mësuesit, janë të obliguar të ndërhyjnë në rast të parregullsive dhe eventualisht për këtë ta informojnë drejtorinë e shkollës. Por, të gjithë bashkëpunëtorët tjerë të kolegjit, në rend të parë edukatorët, janë të autorizuar të kujdesen për funksionin e mbikëqyrjes.
10. Në rast se nxënësit për ndonjë arsye të rëndësishme, janë të obliguar që gjatë orarit të mësimit për një kohë të shkurtër, ta lëshojnë terrenin e gjimnazit – kësaj mund t'i paraprijë pëlqimi me shkrim nga të autorizuarit për edukim – në rastet individuale në mënyrë të jashtëzakonshme nga mësimdhënësi ose nga klasa e vet apo drejtoria e shkollës.
11. Në qoftë se nxënësit udhëtarë, me rastin e mosmbajtjes së orëve të mësimit, dëshirojnë të zgjedhin mjete tjera të komunikacionit nga ato të rëndomtë, nuk do kihen asgjë kundër. Nxënësit, nuk guxojnë të shkojnë në vendndalimet e autobusëve, kurrsesi, më herët se 15 minuta para nisjes.
12. Pirja e duhanit është e ndaluar.

**D. KONSTATIMI I SUKSESIT TË NXËNËSVE**

1. Bazat e vlerësimit të suksesit në një lëndë mësimi, janë të gjitha sukseset që ka treguar nxënësi në lidhje me mësimin (suksesi me shkrim, me gojë dhe ai praktik). Sukseset me shkrim janë sidomos punët në shkollë, punët përsëritëse dhe punët në shkollë pa përgatitje paraprake, të ashtuquajtura extemporale. Mësuesi i lëndës profesionale, para fillimit të mësimi, njohton se si ai parimisht bën vlerësimin e sukseseve të ndryshme gjatë formimit të notës.
2. Formimi i një note, në një lëndë mësimore është një vlerësim i tërësishëm pedagogjik– profesional i suksesit që tregon nxënësi për periudhën kohore të vlerësimit.
3. Kriteret e përgjithshme përcaktuese për vlerësimin e suksesit në lëndët e veçanta, mësuesi i lëndës profesionale, ua paraqet nxënësve dhe sipas kërkesës edhe të autorizuarve për edukim dhe edukatorëve në gjimnaz.
4. Mësuesi i lëndës profesionale, me kërkesën e nxënësit ia tregon atij gjendjen e suksesit me gojë dhe praktik si dhe rezultatin e provimeve të veçanta.
5. Detyrat e klasës hedhin dritë mbi suksesin e mësimi dhe gjendjen e njohurive të një klase dhe të nxënësve veç e veç. Ato, në rrethana të caktuara tregojnë për masat e nevojshme nxitëse dhe për këtë arsye parimisht mund të zbatohen vetëm pas përfundimit të njësisë mësimore, d.m.th. pas fazës së përpunimit, thellimit dhe ushtrimit. Koha e caktuar për punimin e detyrës së klasës, njohtohet së paku disa ditë më parë. Përgjithësimet janë të mundshme vetëm pas marrëveshjes me drejtorin e shkollës.
6. Punimet përsëritëse me shkrim hedhin dritë mbi suksesin e arritur në mësim të dy orëve paraprake mësimore dhe eventualisht mund të tregojnë për nevojën e marrjes së masave nxitëse. Për kryerjen e një punimi përsëritës me shkrim, duhet të parashihen në parim deri 20 minuta.
7. Extemporalet janë provime me shkrim të klasës mbi detyrat shtëpiake apo të materies mësimore të orës paraprake të drejtpërdrejtë, të cilat mund të zgjasin afro 10 minuta.
8. Detyra e klasës dhe punimet përsëritëse me shkrim, duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë gjatë tërë vitit shkollor. Në një ditë, nuk mund të shkruhet më tepër se një detyrë klase. Të hënën dhe në ndonjë ditë pas një feste ligjore, në të gjitha klasat mund të shkruhet një detyrë klase, vetëm atëherë kur paraprakisht është arritur marrëveshja në mes të mësuesit të lëndës dhe klasës. Para kthimit dhe diskutimit të një punimi me shkrim ose në ditën e kthimit të punimit, nuk mund të caktohet punim i ri me shkrim nga e njëjta lëndë.
9. Në rast se një nxënësi, me arsye lëshon kryerjen e një punimi me shkrim (klauzurë), mësuesi profesional vendos se

a do ta kryejë më vonë nxënësi një punim përkatës (klauzurë).

10. Në rast se ndonjë nxënësi, kundërshton të hartojë një punim me shkrim, ose në mënyrë shumë të qartë lëshon pa arsye hartimin e një punimi me shkrim, do t'i jepet nota "pamjaftueshëm".
11. Në qoftë se nxënësi, gjatë një punimi me shkrim, bën ndonjë veprim mashtrues ose tentim mashtrimi, vendos mësuesi i lëndës se a mund t'i qaset punimit për vlerësimin e suksesit, se a do të ndërmerret zvogëlimi i notës, a do të vlerësohet punimi me notën "pamjaftueshëm", ose se a duhet që nxënësi ta hartojë edhe një herë një punim përkatës.
12. Alinetë 9 deri 11, vlejnë në përputhje me kuptimin për sukseset me gojë dhe ato praktike.
13. Në lëndët bazë, duhet të kryhen së paku 6 punime klase. Deri në 8 punime klase, mund të caktohen pa pyetur drejtorin e shkollës. Parimisht, të gjitha punimet e kryera të klasës, duhet të merren parasysh për vlerësimin e suksesit.
14. Në lëndët jo bazë, nuk janë paraparë punime klase. Por mund të hartohen edhe punime me shkrim, në tërësi më së shumti 4 punime gjatë vitit shkollor. Extemporalet, janë të përjashtuara nga ky kufizim.
15. Për një pasqyrë më të mirë, terminet e punimeve të klasës, duhet të shënohen në kalendarin e punës, në dhomën e mësimi.

**E. NJOHTIMET, INFORMATAT NË GJYSMË TË VITIT, DËFTESAT VJETORE**

1. Njohtimet për gjendjen e suksesit shkollor të nxënësve në lëndët bazë, eventualisht edhe në lëndët jo bazë, jepen pas këshillimit në konferencën e klasës për të gjitha klasat 6 deri 13, çdo vjeshtë dhe në pranverë.
2. Pas përfundimit të gjysmëvjetorit të parë, nxënësit e klasave 6 deri 13, marrin informatën me shkrim mbi suksesin e tyre nga të gjitha lëndët mësimore, si dhe për sjelljen dhe bashkëpunimin. Kjo informatë e gjysmëvjetorit, përgatitet pas këshillimit në konferencën e klasës. Me këtë rast, të lejueshme janë notat e plota, notat e plota me tendencë (plus ose minus) dhe gjysmë notat. Ajo, mund të përmbajë edhe shënime tjera plotësuese mbi zhvillimin e suksesit, për personalitetin e nxënësit, apo të ngjashme.
3. Në mbarim të vitit shkollor, nxënësit e klasave 6 deri 13, marrin një dëftesë, në të cilën vlerësohet suksesi i tyre nga secila lëndë e mësimi si dhe sjellja dhe bashkëpunimi i tyre. Ky vlerësim, përfshin tërë vitin shkollor.

## F. MASAT EDUKATIVE DHE NDËSHKIMET PËR SHKELJE TË RENDIT

Në rast se janë të nevojshme masat edukative dhe ndëshkimet për shkelje të rendit, ato duhet të qëndrojnë në raport të arsyeshëm me gabimin, të jenë të caktuara nga pikëpamja pedagogjike dhe të kenë parasysh qëllimin e caktuar të statutit të Asociation "Loyola Gymnasium" si dhe linjën kryesore të edukimit në kolegji. Masat edukative dhe ndëshkimet për shkelje të rendit, duhet t'i shërbejnë nxënësit për zhvillimin personalitetit të tij si i përgjegjshëm.

Masat edukative pedagogjike, sidomos:

- paralajmërimet
- qortimet
- vërejtjet në ditarin e klasës
- punët ushtruese,

parimisht kanë përparësi. Vetëm atëherë kur këto nuk mjaftojnë, mund të vijnë në konsiderim këto ndëshkime për shkelje të rendit:

1. Mësuesi i lëndës profesionale, urdhëron përjashtimin e përkohshëm nga mësimi prej një ore të mësimit. Në këtë rast, nxënësi duhet të qëndrojë para derës së dhomës së mësimit.
2. Në rast të shkeljes së rëndë të rendit, mësuesi i lëndës profesionale ose kujdestari i klasës, mund të urdhërojë:
  - a) përjashtimin nga mësimi për një orë
  - b) të caktojë arrest për dy orë mësimi
  - c) të bëjë regjistrimin në librin e klasës. Regjistrimet (shënimet e tilla në regjistër) – me përshkrimin e ngjarjes – duhet të shënohen në mënyrë të dukshme me "V" (Vërejtje) dhe pa vonesë të shënohen në librin që gjendet në dhomën e mësimit.

Regjistrimet në librin e klasës, parimisht, shlyhen pas gjysmë- vjetorit shkollor, në qoftë se këtë shprehimisht nuk e kundërshton konferenca e klasës.
3. Nëse një nxënës është regjistruar tri herë në librin e klasës gjatë një gjysmë vjetori ("V"), ai do të dërgohet te drejtori i shkollës nga kujdestari i klasës ose tutori. Ai, i shqipton nxënësit qortimin. Prindërit, dhe për nxënësit e

vendosur në konvikt edhe edukatori, do të informohen për këtë. Qortimet nuk tërhiqen për gjysmëvjetor.

4. Në rast se një nxënës pas shqiptimit të qortimit regjistrohet në librin e klasës, atëherë drejtori i shkollës mund të caktojë kërcënimin e përjashtimit të përkohshëm nga mësimi – ose në marrëveshje me konferencën e klasës kthimin prapa në kohën provuese. Edhe për këtë, do të informohen prindërit dhe edukatori.
5. Në qoftë se nevojiten masa të mëtutjeshme, vlejnë këto rregulla:
  - a) Përjashtimi i përkohshëm nga mësimi deri në 4 javë, mund të vendoset vetëm nga konferenca e klasës, respektivisht klasës nën kryesimin e drejtorit të shkollës.
  - b) Përjashtimi nga Gjimnazi, pason sipas statutit të Asociation "Loyola-Gymnasium" dhe në harmoni me këte rregullore.

## G. NXËNËSIT E JASHTËM DHE KONVIKTI

Nxënësit e jashtëm, janë të obliguar të kenë parasysh rregullimet, të cilat dalin nga karakteri i Gjimnazit si shkollë me konvikt. Këto rregulla janë të përfshira në një "Informator" i cili i dorëzohet çdo nxënësi të jashtëm, me rastin e pranimit.

## H. KOHA PROVUESE NË KOLEGJ

Çdo nxënës që hyn rishtas në Kolegj, i nënshtrohet kohës provuese prej 6 muajve. Pastaj, në suazat e një konference të klasës nën bashkëveprimin e drejtorit të Kolegjit, të drejtorit të konviktit dhe të edukatorit përkatës të grupit (te nxënësit intern), konstatohet se a është kaluar me sukses apo jo koha provuese. Në rast se ka nevojë, koha provuese mund të zgjatet për 6 muaj tjerë. Vendimet mbi kalimin me sukses të kohës provuese të nxënësve intern, merren në marrëveshje të shkollës dhe konviktit. Në qoftë se kjo marrëveshje nuk arrihet, vendos drejtori i Gjimnazit.

## Ratio studiorum

### Loyola-Gymnasium Prizren

Duke u bazuar në traditat tona pedagogjike Loyola-Gymnasium, dëshiron që nxënëset dhe nxënësit e vet t'i arsimojë dhe t'i edukojë në atë mënyrë, që të ndiejnë përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit.

**Që të arrihet ky qëllim, Loyola-Gymnasium, duhet të jetë një vend, ku:**

- Secili e njeh identitetin e vet
- Mendon për domethënien e asaj që mëson
- Kërkohej drejtësia dhe shoqëria
- Pyetja mbi Zotin është gjithmonë prezente

**Nga kjo rrjedhë që Loyola-Gymnasium, prë nga kolegji i arsimitarëve:**

- Që nxënësja/si të trajtohet seriozisht
- Të jetë interesimi për nxënës/se
- Respektim i anasjelltë
- Funkcionim shembullor
- Të jenë entuziastë
- Të nxisin përgjegjësi dhe vetiniciativë
- Të japin udhëzime për mësim të pavarur
- Të pranojnë dhe të japin kritika dhe ndihmë vetreflektuese
- Gaditshmëri për komunikim
- Shkëmbim kolegjal
- Përgatitje e kujdesshme para dhe pas mësimit
- Shpërndarje kuptimplote e përmbajtjeve mësimore dhe edukative
- Detyrat e shtëpisë të jenë të rregullta, të kuptueshme dhe qartë të formuluar, me parametra të përshtatshëm, të detyrueshme, të kontrolluara dhe transparente
- Koha e korrigjimit transparente tek vlerësimi dhe përpjekja për vlerësim të drejtë
- Angazhimi për "LG", poashtu edhe jashtë mësimit
- Gaditshmëri për kualifikim të mëtutjeshëm pedagogjik (dhe specifik)

**Kolegji i edukatoreve/ëve**

- Nxënëset/it, të trajtohen seriozisht
- Interesim ndaj secilit
- Zhvillim i personalitetit dhe nxitje të kuptojnë (akceptojnë) lirinë

**Udhëheqësia Loyola-Gymnasium**

- Gaditshmëri për të krijuar një komunikim të hapur

## Ratio studiorum

### Loyola-Gymnasium në Prizren

- Respektim i anasjelltë
- Besueshmëri
- Kompetenca për udhëqje
- Fleksibilitet
- Përkrahje dhe nxitje për iniciativë
- Vendosshmëri transparente
- Përgjegjësi kritike në sjellje dhe vlerësime
- Vetreflektim

**Bashkuntoret e Loyola-Gymnasium**

- Qëndrushmëria aktive në mësim
- Pjesëmarrja konstruktive në mësim ("dëshira për më shumë")
- Kryerja e detyrave të shtëpisë: me kujdes, në mënyrë të pavarur, dhe përdorim i mirë i kohës
- Punë e vazhdueshme (ndarje e kohës në periudha të gjata)

**Prindërit**

- Përkrahje aktive e qëllimeve edukative të Loyola-Gymnasium
- Përcjellja e zhvillimeve të mësimoreve ditore në shkollë
- Kontakti i rregullt me mësuesin dhe edukatorët

**Udhëheqësia Loyola-Gymnasium**

- Gaditshmëri për të krijuar një komunikim të hapur
- Kompetenca për udhëqje
- Fleksibilitet
- Përkrahje dhe nxitje për iniciativë
- Vendosshmëri transparente
- Përgjegjësi kritike në sjellje dhe vlerësime
- Vetreflektim

**Jeta në Loyola-Gymnasium**

- Së bashku me veprimtarinë e shtëpisë
- Qendra e Loyola-Gymnasium, është përgjegjësi e plotë dhe kujdes për thjeshtësi
- Një maturiri i stilit jetësor dhe përkrahja e caktit të përbashkët

Edukimi është diçka që e kërkon jeta, prandaj edhe është botërisht i pranuar. Për shkak të qëndrimit pozitiv ndaj botës, ai e sheh të vlefshme që të hulumtojë çdo gjë. Nxënësit, duhet që parimisht të jenë të hapur ndaj të gjitha pyetjeve dhe problemeve – jo vetëm gjatë orarit mësimor. Arsimit nuk përbëhet vetëm nga transmetimi i dijes dhe i aftësive funksionale. Andaj, formimi i personalitetit shihet si njëri nga qellimet kryesore të një përgatitjeje të mirë shkollore krahas njohurive të përgjithshme arsimore. Këtu edhe qëndron vlera e arsimit.

Transmetimi i vlerave në Loyola-Gymnasium, në Prizren, në njërin anë bëhet përmes kuadrit (edukatorëve dhe mësuesve) të zgjedhur me kujdes dhe shembujve që ata u sjellin nxënësve nga jeta e përditshme dhe në anën tjetër përmes mësimi të lëndëve adekuatë.

Aspektet kryesore të formimit të personalitetit, i përkasin aftësive shoqërore, si aftësisë për të kritikuar, ndjeshmërisë dhe kreativitetit, por para së gjithash respektit dhe afërsisë ndaj të tjerëve.

Këto mundësi, i ofron veçanërisht një shkollë me konvikt, ashtu siç do të jetë edhe Loyola-Gymnasium, në Prizren: gërshetimi i ngushtë mes jetës dhe mësimi, mes mësimi dhe kohës së lirë, do të mundësojë një edukim dhe arsim të mirë. Këtu, mund të mësohen dhe të ushtrohen sjelljet shoqërore. Kështu do të arrihet edukimi i grupeve të nxënësve në konvikte, që do t'i përshtatet moshës dhe mundësive që ofrojnë metodat moderne pedagogjike. Jemi të bindur, se pasuria e mendimit evropian, është një fundament ideal i njohurive që shpien deri tek arsimi.

Edhe nëse jeta dhe mësimi në shoqëri shumëçka lehtësojnë, arsimim pa përpjekje, nuk ka. Shkolla jonë është një institucion arsimor, e cila i përgatit nxënësit për të ardhmen dhe kërkon nga ata një angazhim të madh personal.

Edukimi në Loyola-Gymnasium, bashkon vlerat tashmë të dëshmuara me kërkesat e kohës. Në Loyola-Gymnasium, në Prizren, në kuadër të edukimit, bën pjesë edhe mësimi i gjuhëve të huaja, si i asaj latine, gjermane dhe angleze, gjithashtu edhe mësimi i shkencave moderne natyrore.

Dija dhe talenti i fituar, nuk duhen t'i shërbejnë vetëm nevojave personale, por duhet të përdoren edhe në të mirë të shoqërisë. Edukimi në Loyola-Gymnasium, në Prizren, i përket anës shoqërore. Ajo kuptohet si një pjesë e idesë evropiane dhe dëshiron të shtrojë kërkesën për drejtësi shoqërore. Ky angazhim, duhet të shpie deri tek shërbimi i shkëlqyeshëm dhe deri tek marrja përsipër e një pozite me përgjegjësi në shoqëri.

Njerëzit, posedojnë talent dhe mundësi të ndryshme. Kështu që ne, nuk guxojmë të vëmë kritere të njëjta matëse në kuptimin e vlerësimit të aftësive të tyre. Prandaj, secili nxënës i shkollës sonë, duhet që sa më shumë të mundohet t'i zgjerojë njohuritë dhe aftësitë e tij. Interesimin, aftësinë dhe gadishmërinë për punë, ne e kërkojmë në mënyrë të njëjtë si prej nxënësve, prindërve të tyre, natyrisht edhe prej vetvetes.

Kështu Loyola-Gymnasium, në Prizren, me konviktet e tij, dëshiron që nxënëset dhe nxënësit, jo vetëm ta përfundojnë shkolimin me një sukses të mirë, por edhe të formojnë një personalitet, i cili do të përmbante vlera dhe qëllime evropiane. Të prirë (të ndikuar) nga motoja "njeriu për të tjerët" secili me vetdije dhe përgjegjësi do të duhej të rregullonte jetën e shoqërisë dhe kësaj bote në përgjithësi.



## Stichpunkte und Gedanken

### Multum non multa

In welche Richtung muss Schule marschieren, wenn sie ihre Schülerinnen und Schüler qualifizieren will, die Aufgaben der Zukunft zu meistern – unsere Welt wird immer vernetzter, damit immer komplexer und das in einem System sich rasant verändernder Informationen und Entscheidungsstrukturen.

**Folge 1:** Schüler müssen, wenn sie Führungsaufgaben übernehmen sollen, darauf vorbereitet werden, auch auf Grundlage nur bruchstückhafter und unvollständiger Informationen sachgerecht und verantwortungsvoll zu entscheiden.

**Folge 2:** Es braucht dazu einen begründeten, wertorientierten Standpunkt, der nicht nachzuschlagen ist, sondern der man selber ist, d. h. es braucht Bildung.

**Folge 3:** Der Unterrichtsstoff muss so angelegt sein, dass er zu Transferleistungen des Schülers anregt, nicht nur innerhalb des Fachgebietes, sondern auch zwischen den Fachgebieten.

**Folge 4:** Vom Üben und Nachvollziehen des Gelernten muss es zu selbständigem Lernen kommen, d. h. Informationen müssen selbständig beschafft, organisiert und kontrolliert werden, um so verantwortliches Entscheiden und verantwortungsbewusstes Handeln einzuüben.

**Folge 5:** Es muss die Freiheit gewährt werden, außerhalb des üblichen Rahmens von Schule und Unterricht Probleme anzugehen. Es bedarf also der Nicht-Konventionalität.



#### **Zusammenfassend:**

Schule muss zukünftiges Leben ermöglichen, nicht es behindern oder was noch schlimmer wäre, über weite Strecken verunmöglichen. Es reicht also durchaus, Grundlagenwissen in den Kernfächern zu stärken und Spezialwissen nur in dem Maß zu vermitteln, dass die allgemeine Studierfähigkeit gegeben ist.

## Pikat kryesore dhe idetë

### Multum non multa

Nga duhet të marshojë shkolla, nëse dëshiron që nxënës të kualifikojë, në mënyrë që ata të jenë të gatshëm t'i zotërojnë detyrat e të ardhmes, në këtë kohë kur bota rreth nesh, gjithnjë e më shumë, po lidhet \* (bashkohet), e me këtë po rritet edhe kompleksiteti i saj, kështu që e tëra po përbën një sistem ku informacionet dhe strukturat vendosëse vrellshëm ndryshojnë.

**Rezultati 1:** Nëse nxënësit duhet të marrin përsipër detyra udhëheqëse, ata duhet të përgatiten për këtë, kështu që edhe në bazë të të dhënave jo të plota, ata të jenë në gjendje të vendosin në mënyrë të përshtatshme dhe me përgjegjësi të plotë.

**Rezultati 2:** Për këtë nevojitet një pikëpamje e orientuar nga vlerat dhe argumentet, të cilat duhet të jenë të qëndrueshme, për këtë pra nevojitet arsimim.

**Rezultati 3:** Përmbajtja e mësim, duhet të jetë e tillë që të nxisë aftësitë e nxënësit për t'i transferuar njohuritë e tij jo vetëm brenda një lëndë të caktuar, por edhe në lëndë të tjera.

**Rezultati 4:** Ushtrimet dhe përsëritjet, duhet të shpiejnë deri tek mësimi i pavarur. Kjo do të thotë që nxënësit vet duhet t'i gjejnë, t'i organizojnë dhe kontrollojnë të gjitha të dhënat, me qëllim që të mësojnë të vendosin dhe veprojnë me përgjegjësi.

**Rezultati 5:** Nxënësve duhet t'u jipet liria, që të mirren edhe me probleme që nuk kanë të bëjnë me shkollën dhe mësimin. Çka do të thotë se atyre u duhet jokonvencionaliteti.

#### **Përmbledhja:**

Shkolla, në të ardhmen, duhet ta mundësojë jetën, e jo ta pengojë, ose çka do të ishte edhe më keq, ta bëjë të pamundur atë. Do të mjaftonte plotësisht, që të përforcohen bazat e njohurive në lëndët themelore, kurse njohuritë speciale të ulen deri në atë masë, që të mos t'i pengojnë aftësitë e përgjithshme të studimit.



Edukimi është i domosdoshëm që njeriu të arrijë atë për të cilën është i krijuar, pra që të jetë Njeri në plot kuptimin e fjalës. Pra edukimi dhe formimi është diçka që e kërkon jeta dhe që duhet të bëhet gjithë jetën. Edukimi është një ndihmesë dhe obligim etik dhe moral, një aktivitet individual ashtu edhe shoqëror për promovimin e rritjes dhe kualitetit njerëzor të jetës sonë dhe të tjerëve. Edukimi është veprim personal dhe shoqëror, i cili është i përqendruar në mënyrë të veçantë mbi personalitetin në formim. Vetë fjala formim, korrespondon me fjalën latine – *formatio* – trajtim, krijim, lindje. Poashtu edhe në gjuhën gjermane – *Bildung* – d.m.th. formë, të formohet ajo/ai e/i cili/a, ende nuk e ka arritur formën, të konstruktohet, të arrihen kompetencat për të ushtruar një rol individual dhe shoqëror. Një rol profesional dhe më në fund aktivitet i vazhdueshëm të cilësive njerëzore e jetësore si dhe zhvillim në çdo aspekt (psiko-fizikë, shpirtëror dhe kulturor).

Investimi në edukimin e gjeneratave të reja, mendoj se është një ndër nevojat, njëherit edhe obligimet më të mëdha që sot mund t'i bëjmë për një të ardhme më të mirë të vendit dhe popullit tonë posaçërisht rinisë dhe njerëzimit. Një shtet e formon populli, pra individët, prandaj si e kemi formuar njeriun ashtu e kemi edhe shtetin. Të tillë do ta kemi edhe të ardhmen tonë, pavarësisht se ajo

shpeshherë është e influencuar nga pasojat e së kaluarës. Siç e dimë, njeriu është qenia më e përsosur, por në të njëjtën kohë, ai është edhe më e komplikuar. Personi jeton të tashmen, kujton të kaluarën dhe ëndërron të ardhmen. Njeriu është një "mister-fshehtësi", shumë i pasur dhe i pa zbuluar në vetvete. Për këtë arsye, është i nevojshëm edukimi dhe vetedukimi. Sepse njeriu merr prej të tjerëve, por disa gjëra i zgjedh vet sepse ai është i lirë të vendos. Pra liria, është një dhuratë por edhe obligim i njeriut, që atë e dallon prej qenieve tjera të gjalla. Me lirinë, ai mund të zgjedh dhe të vendos për disa gjëra jetësore. Liria dhe përdorimi i saj, duhet të edukohen dhe të përdoren në mënyrë të mirë dhe pozitive!

Është e vërtetë se edukimi gjithmonë e sidomos sot, është shumë i vështirë por i'a vlenë që të punosh dhe të veprosh në këtë fushë.

Por duhet cekur edhe një gjë shumë të rëndësishme: për të arritur rezultate sa më të mira në edukim, nevojitet bashkëpunim reciprok. Pra, në rend të parë mes prindërve, edukatorëve si dhe arsimtarëve. Familja ka qenë dhe mbetet djepi ku fëmija i merr dhe mëson gjërat elementare jetësore. Sot fëmijët rriten në "qendra" të ndryshme: në çerdhe, kopshte, por pjesën më të madhe të kohës e kalojnë edhe në rrugë. Vendin e prindërve, askush nuk e zëvendëson. Dhe atë që prindi e transmeton tek fëmija, jo aq me fjalë sa më jetën e vet, është themelore. Sepse fëmija i vogël është pors i shpuzë që thith gjithë atë që sheh, dëgjon dhe përjeton. Ata janë imituesit më të përsosur të të rriturve.

Për arritjen e një edukimi, nevojitet një trekëndësh i shkëmbimeve të forcave dhe veprimeve të vazhdueshme; gërshtëtimi i ngushtë mes jetës dhe mësimi, mes mësimi dhe kohës së lirë, mes çasteve të lumtura dhe atyre të hidhura, mes punës dhe pushimit. Të gjitha këto, mundësojnë një edukim dhe arsimim të mirë dhe të vazhdueshëm, sepse njeriu edukohet gjatë tërë jetës.

Besoj se edukimi ka rëndësi të madhe dhe parimore, prandaj është më se e nevojshme, që njeriu gjatë tërë jetës së vet të edukohet, të edukojë të tjerët dhe të lejojë të edukohet.

Të edukosh, do të thotë të jetosh së bashku, duke i njohur nevojat e njëri-tjetrit, duke përfutur nga çdo rast që të ndihmojmë duke bashkëndarë. Për sa i përket kushteve, në edukim, vendi dhe koha janë gjithmonë të përshtatshme, pra nuk ka vend dhe kohë të pavolitshme për edukim. Formimi i personalitetit, shihet si njëri ndër qëllimet kryesore të një përgatitjeje të mirë shkollore, krahas njohurive të përgjithshme arsimore.

Të edukosh sot, në një botë ku teknologjia dhe mjetet e komunikimit janë në qendër të vemendjes, ku edhe fëmijët tanë kalojnë në shumtën e kohës pranë ekraneve televizive dhe interneteve, pa kurrfarë kontrolli e pa mbikqyrje nga të rriturit dhe thithin atë çka "mass media" iu ofron, pa bërë kurrfarë dallimi dhe vlerësimi. Sipas meje, kultura nihiliste, relativiste dhe bioteknologjike, krijojnë mendime dhe personalitete të dobëta. Sepse ide të tilla, mbizotrojnë mbi ekzistencën e të gjithëve, posaçërisht të të rinjve. Sot, duket se jetojmë në një realitet "virtual", i cili nuk i përshtatet aq shumë realitetit dhe të vërtetës, për atë edhe të rinjtë janë më të rrezikuar. Pra, nuk është fare e lehtë të edukosh sot, kur rendi i vlerave dhe virtyteve themelore është ndërruar me ato që janë efikase dhe relative. Ku familja dhe thelbi i saj nuk janë më prindërit dhe fëmijët, por luksi dhe pasuria. Kur globalizimi dhe privatizimi, i kafshon masat e njerëzve që nuk mund të mbijetojnë.

Sot, shoqëria është e ndarë në shtresa si në kohërat e Mesjetës, në ato të "Pasanikëve-biznismenëve dhe të varfërve". Kurse fëmijët në dinjitetin e tyre njerëzor, duhet të jenë të vlerësuar dhe të barabartë. Pra, kësaj shoqërie, i nevojitet respekti dhe toleranca ndaj qenieve njerëzore, pa marrë parasysh kombin, fenë, racën, përkatësinë, ndarjen, apo gjendjen ekonomike, familjare.



Për t'iu rikthyer rrënjëve tona, dhe për ta rizbuluar identitetin tonë, na nevojitet, mbi të gjitha, një zgjuarje dhe vetëdijësim, për të ditur ku jemi dhe çka dëshirojmë nga e ardhmja jonë? Na nevojitet, që njëherë e përgjithmonë të vetdijesohemi. Duhet të ndërmmarrim hapa seriozë, nëse dëshirojmë të bëjmë pjesë në Evropën e Bashkuar; atëherë mbi të gjitha duhet që të punojmë për të mirën e përbashkët, e kjo gjë neve si popull dhe si kombësi, gjithmonë na ka munguar. Kjo ka qënë edhe arsyeja që kemi qënë të sunduar me shekuj nga sundues të ndryshëm. Kjo është edhe pasoja e asaj që edhe sot e përjetojmë. Ekziston edhe një gjë e tjetër, në të cilën duhet të punojmë në edukim e kjo është: që t'i mësojmë fëmijët që ta përkrahin dhe mbështesin njëri –tjetrin.

Na duhet t'i edukojmë gjeneratat e reja, që të jenë përgjegjëse për atë që janë dhe atë që bëjnë. Sepse njeriu, në rend të parë është e atëherë vepron.

Pra, t'i rikthehem pyetjes, të cilën në titull e kemi parashtruar: Pse një shkollë me konvikt? Vet fjala konvikt, rrjedh nga fjala con+vivum, pra bashkëjetesë. Sot, kjo pyetje, duket së është pyetje kyçe, jo vetëm se duhet të bashkëjetohet me një popull tjetër, por të bashkëjetohet në familje, e cila është vet shteti-miniatural (në miniaturë).

Pran, ëse ne dime të jetojmë, bashkëtojmë dhe të komunikojmë, relacionojmë mirë në një familje, atëherë kemi gjasa se do të bashkëpunojmë dhe bashkëtojmë edhe në shkollë, edhe në shoqëri edhe në një shtet dhe kështu do të krijojmë një "Union", bashkësi jo vetëm të interesave vetjake, por edhe bashkëjetimi dhe bashkëpunimi. Për këtë arsye, është paraparë se është e nevojshme që shkolla të ketë konviktin, pra që fëmijët të mësojnë të bashkëtojnë dhe bashkëpunojnë për vetvete dhe për të mirën e përbashkët. Sipas psiko-pedagogjisë, është e njohur edhe faza ku të rinjtë në këtë moshë identifikohen më shumë me grupin dhe moshatarët e vet. Pra është faza ku ata kanë nevojë të krijojnë lidhje dhe relacione jashtë gjirit të ngushtë familjar.

Përveç kësaj, konvikti jep rastin dhe mundësinë, që në këtë shkollë të edukohen dhe arsimohen fëmijët e mbarë Kosovës dhe të diasporës.

Për këtë, qyteti i Prizrenit, është shumë i përshtatshëm, sepse gjendet në rrugën lidhëse mes Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Në të vërtetë, Prizreni, përveç shtrirjes gjeografike, që lidh shtetet fqinje ballkanike, ka edhe një specifikë tjetër të favorshme-kultivimin e bashkëjetesës multikulturore dhe multikonfesionale.

## Veranstaltung

## Aktiviteti

Erster Tag

12. September 2005

Dita e parë

12 shtator 2005

Mëngjesi i kësaj dite, erdhi me diell të ngrohtë si ç'ishte e ngrohtë zemra e hapur e mikpritësve. Ky mëngjes, për nxënësit e sapopranuar dhe për të tjerët që po pretendonin ende të bëhen nxënës të "LOYOLËS"; për arsimtarët dhe për drejtuesit e shkollës, ishte më shumë se solemn. Dukej sikur dikush me një dorë të fshehtë, kishte sjellur rregull dhe kishte drejtuar gjithëçka përreth.

Në orën 9. 00, ishin bërë pothuajse të gjitha përgatitjet e duhura, për pritjen e të gjithë mysafirëve. Me fjalë tjera, gjithëçka ishte e gatshme për një takim që do të mbahej në mend.

Amfiteatri i hapur, së shpejti u mbush sa nuk zinte më. Nuk kishte vend për t'u ulur të gjithë. Shumë qytetarë, nxënës e prindër qëndronin në këmbë, por në sytë e tyre rrezatonte një kureshtje e papërshkruar dhe një dashamirësi shumë premtuese. Përbërja e mysafirëve ishte imponante. Midis tyre, binte në sy l'peshkvi i l'peshkvisë së Kosovës, z. Mark Sopi me bashkëpunëtorët e tij, të dërguarit e Brigadës Shumëkombëshe Jug - Perëndim, zv. ministri i MASHT-it, z. Ruzhdi Berisha, zyrtarë komunal të Drejtorisë së arsimit, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare në Prizren e Kosovë, Shoqata Joqeveritare vendore-ndërkombëtare, prindër, nxënës dhe qytetarë të interesuar për këtë ngjarje të rëndësisë së madhe shoqërore.

Të gjithë këta, panë ambientin në të cilin tash e tutje do të mësonin e do të edukoheshin gjenerata e gjenerata fëmijësh, për kohët që dotë vijnë shpejt dhe pashmangshëm. Ata, dëgjuan fjalën e z. Happelit dhe ndoqën një program artistik të shkurtë, pas të cilit shijuan bukën, kripën dhe ujin e shtruar në sofrën e mikpritësit. Në sytë e tyre, shkëndijonte, drita e besimit, se kjo shkollë, do të udhëhiqej e do të përparojë, nën drejtimin e nikoqirit të mirë të ndihmuar nga arsimuesit e zellshëm e optimistë.



## Veranstaltung

Zweiter Tag  
13. September 2005

## Aktiviteti

Dita e dytë  
13 shtator 2005

Mëngjesi i dytë i vjeshtës që po afronte, solli dallëndyshet të cilat hoqën dorë nga dyndja për në vendet e ngrohta, sepse e kërkuan dhe gjetën një çerdhe të ngrohtë në "Loyola-Gymnasium", në Prizren. Këto dallëndyshe, ishin nxënësit tanë.

Oborri i shkollës gumëzhinte nga zhurma e gëzuar e nxënësve.

Në orën 7. 45, cingërroi për së pari herë zilja e kësaj shkolle. Cingërrima e saj, i mbledhi në rresht të gjithë, pakëz të hutuar në atë gëzim të ri. Para tyre qëndronte z. Happel dhe kujdestarët e të gjashtë klasave, të cilët bënë apelin dhe pastaj i drejtuan nxënësit e rreshtuar, drejt klasave të bëra gati për ta. Edhe te arsimtarët kujdestarë e te arsimtarët tjerë, u panë emocionet e çastit solemn.

Në klasa, nxënësit i priste edhe një befasi– uniforma shkollore tringjyrëshe : e kaltër, e verdhë, e hirtë. Shumë shpejt, ata, e ndërruan veshjen e tyre të përditshme, të deriatëhershme–me uniformën shkollore. Kjo gjë, për ta ishte një përvojë e re dhe e panjohur. Të gjithëve, u interesonte të dijnë e të shohin se si dukeshin në petk të ri.

Edhe njohja me arsimtarët–kujdestarë, ishte një çast i shënuar dhe emocionues.

Paqartësia po shprishej gjithnjë e më shumë. Dita e dytë thelloi njohjen.



Mbasi që u mendua të realizohet projekti, p. Happeli kerkoi nga Ipeshkvia e Kosovës, një bashkësi rregulltare për bashkëpunim. Ipeshkvia, ia propozoi Motrat shkollare, pasi që karizma e tyre ishte edukimi.

Pra, motrat që sot jetojnë në Konviktin Loyola, janë Motrat Françeskane Shkollare të themeluara në Graz, më 1834, në Austrisë, nga themeluesja austriake m. Franciska Antonia Lampel.

Karizma apo e veçanta e veprimtarisë së tyre, është përkatësisht edukimi dhe emancipimi i vajzave.

Motrat, e kryejnë këtë detyrë prej vitit 1843, pra plot 163 vjetë. Eksperiencia e tyre, është më se e madhe në fushën e edukimit. Motrat, përveç që shërbejnë në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe Kroaci, ato janë të pranishme edhe në disa vende tjera siç është shtëpia kryesore në Graz- Austri, Gjermani, Francë, Brazil, Afrikën Jugore, Bregun e Fildishtë etj..

Motrave, mbas Luftës së Dytë Botërore, në vendet komuniste, nuk u qe lejuar që të veprojnë në fushën e edukimit, për këtë arsye, ato filluan të punojnë në spitale dhe veprimtari të tjera të ndryshme.

Gjenerata me radhë, që na paraprinë në fushën e edukimit dhe arsimimit, ishin edhe meshtarët dhe motrat e nderit të cilët i nxiti i njëjti ideal. Moto françeskane është "Për fe gjuhë dhe atdhe", që të punojnë dhe veprojnë për këtë. Disa prej tyre, dhanë edhe jetën. Kjo ishte jo vetëm ideal, por realizim i jetës së tyre në shërbim të Zotit dhe për Zotin në shërbimin e të afërmit njeriut.

Pra, ideali i njejtë, i nxiti dhe i përcolli Motrat Françeskane apo Shkollare, që edhe sot e kësaj dite ta kushtojnë jetën e vet dhe të veprojnë e punojnë në Kosovë, në fushën e edukimit dhe arsimimit, ashtu si në vendet tjera të botës. Sepse siç e dime mirë, visarin e diturisë dhe kulturës së lashtë, e ruajtën kush tjetër, përveç paraardhësit tanë edhe pse të përndjekur dhe të salvuar me shekuj nga sunduesit që dëshironin ta zhduknin identitetin tonë kombëtar dhe fetar.

Motrat punojnë më fëmijët e Kosovës, të cilët kanë nevojë për edukim dhe një ardhmëri të lumtur, pra pa marr parasysh fenë dhe prejardhjen etnike dhe fetare. Në Zotin, njihemi të gjithë si vëllezër e motra të të njejtit Atë dhe vetëm kështu, mund të bashkëpunojmë dhe bashkëjetojmë për të mirën e përbashkët.




## Internat

Erster Schultag  
Dardan Shabani VIII b

## Konvikti

Dita e parë e shkollës



Qershor. Një ditë ndërsa po lexoja gazetën, menjëherë në sy më ra një artikull që më bëri shumë përshtypje. Aty flitej për një shkollë që premtonte se do t'i plotësonte të gjitha kushtet për arritjen e mësimave sa më kualitative. Ato premtime, m'u dukën mjaft bindëse. Mezi prita momentin kur do të vinte babi në shtëpi.

Sa u thash, prindërit menjëherë u interesuan për regjistrimin tim. Babi, shkoi dhe e mori aplikacionin. Në fillim, më regjistroi vetëm për shkollë, kështu që u përgatita që të udhëtoja. Por kur i pamë kushtet që ofronte konvikti i kësaj sholle, babi, automatikisht më regjistroi edhe në konvikt.

Dalëngadalë erdhi dita e 11 qershorit, që e prisja me padurim, sepse do të vija në shkollën e ëndrrave të mia. Kur erdha, ç'të shikoja: shkolla nuk ishte përfunduar ende, akoma ishte rrëmujë. Por edhe pse dukej ashtu, mua më dukej se gjithçka shkëlqente si diell, më dukej se rrezet e tija të zjarrta do të ma hapin rrugën e diturisë. Ky diell, ëndrrat e mia do të m'i bënte realitet.

Që në fillim, më interesonte të dija se kush ishin iniciatorët e këtij projekti. Shumë shpejt mësova se p. Happel dhe të tjerë ishin ato burimet e pashtershme "të hidrogjenit" që nuk do ta linin këtë diell të shuhej.

Tani ky diell, ka krijuar galaksinë e tij edhe me nxënës të mirë që po prodhojnë "hidrogjen" të nevojshëm për një të ardhme më të mirë, të tillët kjo shkollë i pranon me dyer të hapura.

## Internat

## Konvikti

### Ein Anfang

### Safete Bytyçi VIII a

### Fillimi



Si çdo fillim edhe ky ishte fillim i vështirë. Por, ne edhe pse fëmijë, e kishim parasysh sakrificën dhe kontributin e madh të prindërve tanë që na mundësuan regjistrimin në një shkollë të tillë. Kjo vetëdije, na dha kurajo që t'i përballojmë vështirësitë e çdo fillimi: largimin nga familja, rrethi, shoqëria dhe pranimin e një shoqërie të re, e krejt tjetër prej asaj që kishim më parë. Ky ishte suksesi ynë më i madh.

Përveç shkollës së re që fituam, për neve që erdhëm këtu, ishin edhe disa suksese tjera: ne patëm rast të njoftohemi me shokë e shoqe të vendeve të ndryshme. Këtu, gjetëm motrat e nderit, mësimdhënës të shkëlqyeshëm, që na ofruan mësim shumë më të mirë nga ai që kishim në shkollat tjera.

Kur filloi mësimi, si fillestarë të kësaj shkolle, e kishim një dëshirë dhe vullnet të fortë: që të arrinim rezultate sa më të mira, që të tregonim se ne vërtetë e meritonim të ishim nxënës të kësaj shkolle. Kjo, na bëri që ta sfidojmë frikën që mbizotëronte tek ne, se a do ta gjenim veten në këtë mes të veçantë. Por duke iu falënderuar të gjithë edukatorëve, ne krijuam rrethin, përvetësuar rregulloret e ambientit të ri. Këtu gjetëm ngrohtësinë e mirëkuptimit e motrave. Për çdo nevojë që kishim, ne e dinim se ku mund të gjenim përgjigje.

Në këtë shkollë, mësuam se si duhet rrespektuar rregulli jetësor. Këtë na mundëson mjaft rregullorja e konviktit dhe e shkollës. Që në fillim, ne dhe prindërit tanë, u njoftuam me rregulloren e konviktit. Më së paku na pëlqente shkuarja në shtëpi, një herë në dyjavë, përveç pushimeve tjera të kalendarit shkollor, që ofronte edhe pushime tjera më të gjata.

Në fillim, dyjavëshi në konvikt, na u duk shumë i gjatë. Mirëpo, duke na u ofruar edhe aktivitete tjera arsimore, edukative dhe sportive, filluam të adaptohemi.

Si në konvikt ashtu edhe në shkollë, na ofruan kushte të mira optimale për jetesë dhe për mësim.

Në fillim, më ka bërë përshtypje edhe numri i madh i vizitorëve si nga Kosova ashtu edhe nga Evropa, vërtetë ishte numër shumë i madh.

## Internat

### Das erste Jahr im Internat am Loyola-Gymnasium



kështuqë 3 javët e para ne nuk kishim ujë të nxehtë ku fëmijët mund të pastroheshin, por na është dashur të nxejmë ujin e t'ju japim fëmijëve me kova.

Pastaj kuzhina ishte e papërfunduar. Ushqimin na sjellnin ushtarët e K-forit gjerman nga kazerma më e afërme, kurse për mëngjes dhe darkë jemi kujdesur ne vetë.

Në fillim ne nuk kishim kurrfarë automjeti t'i sjellim artikujt ushqimor, por u gjetëm disi në mënyra të ndryshme me ndihmën e bamirësve – shpeshhëherë.

Pra, çdo gjë ishte në ndërtim e sipër. Për fat, dimri dhe të ftohtit nuk filloi aq shpejt. Deri në muajin nëntor nuk e kishim të rregulluar nxemjen. Gjithashtu për pastërtinë dhe mirëmbajtjen e shtëpisë u kujdesëm ne vet, kjo vështirësonte edhe më shu-

Në fillim ne patëm shumë vështirësi: derisa fëmijet u adaptuan, ata mërzhiteshin dhe qanin ashtu që muaji i parë ishte muaj ngushllimi; prej nervoze fëmijët vet hanin (as që dinin se çfarë bënin), mbeturinat i hidhnin pa kurrëfarë kontrolli. Jëra prej nesh është dashur të rri vetëm me fshesë e xhoger në dorë. Orari nuk ju konvenonte, sespe ishin mësuar të mos kenë kontrollë nga prindërit – nuk flinin para orës 23, 24; nuk hanin gjellërat e konviktit, sepse ishin mësuar me ushqim të thatë etj, etj. Por, pas disa javësh, apo muajsh filloi jeta të ec përpara, filluan edhe mësimet e notat e para e kështu jeta në konvikt filloi rrjedhën e vet për së mbari.

Përveç mësimet dhe edukimit në konvikt, vikendeve kur fëmijët qëndronin në konvikt. Ne, kemi organizuar edhe vizita të karakterit artistiko-kulturor. Sepse me rritjen e inteligjencës, janë të nevojshme edhe rritja e njohurive për vendin dhe kulturën e tij. Për këtë arsye, përveç vendeve tjera piktoreske ne vizituam edhe monumente historike. Kështu për shembull, ne vizituam disa vende të rëndësishme siç janë: Muzeu i Lidhjes së Pri-

## Konvikti

### Viti i parë në konviktin ne Loyola-Gymnasium

Më 07. 09.2005, m. Shpresa dhe unë, kaluam në banesën tonë në pjesën e konviktit të vajzave, ku sado kudo, të parat përgatisim terenin për ardhjen e nxënësve në konvikt. Me 11.09.2005, në orët e pasdites, arritën nxënësit dhe u vendosën: vajzat në katin e I kurse djemtë në katin e II.

Gjithsejt ishin 43 nxënës, prej tyre 26 djem dhe 17 vajza.

Gjatë vitit shkollor, konviktin e lëshuan 5 fëmijë, për arsye të ndryshme.

Gjatë vitit shkollor 2005/6, në konvikt qëndruan 37 nxënës, 22 djem dhe 15 vajza. Me ta punuam 2 edukatorë, me orar të plotë dhe 3 arsimtarë me gjysëm orari.

Viti i parë dhe puna në konvikt, ka qenë shumë e vështirë, por edhe interesante dhe dinamike në të njëjtën kohë. Nuk ishte fare lehtë, sepse nxënësit nuk ishin ndarë kurrë më parë nga prindërit e tyre dhe nga rrethi familjar për kohë aq të gjatë; pastaj rrethi i ri, shoqëria, shkolla, arsimtarët rendi shtëpiak dhe diciplina ishin për ta një vështirësi e madhe. Shumica prej tyre as që kaë pasur një orar të rregullt në familjet e tyre.

Në fillim të vitit shkollor, nuk kishim as kushtet elementare,



zrenit, Kalanë e Prizrenit, xhaminë e Sinan Pashës që është xhamia kryesore e qytetit të Prizrenit, hamamin e Prizrenit, kop-shtin zoologjik, burimin e Drinit, manastirin e Deçanit, Patrikanën e Pejës e.t.j..

Përveç këtyre shetitjeve, ne realizuam edhe shetitje në natyrë. Në mënyrë të veçantë, i falënderohemi edhe grupit të të rinjëve, "Pjetër Bogdani" nga Prishtina, të cilët na ofruan kohën e tyre të lirë të shtunave pas dite, kështu së bashku me nxënësit tanë animuan me lojëra të ndryshme shoqërimi.

Përveç këtyre gjërave, ne organizuam edhe disa festime gjatë vitit shkollor, siç janë: Dita e flamurit, Festën e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, festën e Dyerve të Hapura, apo ditën e shkollës.

Nxënësit tanë, moren pjesë edhe në gara të nivelit komunal në Prizren për arte (letërsi dhe art figurativ), ku prej disa shpërbli-meve të ndara, 3 të parat i fituan nxënësit tanë.

Në gjysëmjetorin e dytë KFOR-i– gjerman, e mbajti një trajnim për Ndihmë të Parë.

U mbajt edhe garimi i leximit në gjuhën gjermane, turnire të futbollit dhe tenisit.

Më në fund, çka të them tjetër, përveç se nxënësve t'ju dëshiroj suksese në mësim dhe njehërit ju uroj jetë të lumtur dhe një ardhmëri të mirë dhe të suksesshme! Sepse ardhmëria dhe suksesi i tyre është sukses për ne dhe vendin tonë në përgjithësi.



## Veranstaltung

### 1. Vorlesewettbewerb Preisverleihung

Lesen gefährdet Dummheit!

**"Alles mal herhören! Wir lesen vor!"**

In einem immer enger zusammenwachsenden Europa und einer globalisierten Welt erhalten fundierte Fremdsprachenkenntnisse für junge Menschen außerordentliche Bedeutung. Lesen ist dabei sowohl in der Muttersprache als auch in den Fremdsprachen eine wichtige Schlüsselqualifikation.

Wenn es gelingt, durch schulische Leseförderung die Lesesfreude zu wecken, zum Lesen anzustiften und dem Lesen einen festen Platz im Alltagsleben der Kinder und Jugendlichen zu sichern, dann wird sich auch die Lesekompetenz weiter entwickeln. Wer viel liest, erfährt viel, kann neu erlesenes Wissen mit vorhandenen Wissensbeständen verknüpfen und sich mit anderen darüber austauschen.

Am 27. April 2006 veranstaltete das Loyola-Gymnasium deshalb erstmalig einen Lesewettbewerb in Deutsch. Dabei lasen die teilnehmenden Schüler der Klassenstufen 6 und 7 vorbereitete Texte und unbekannte Textstücke vor.

Beurteilungskriterien waren: Gliederung durch Tonfall und Pausen; Vokale, Konsonanten, Akzent; Intonation; Flüssigkeit und Sprechtempo. Aus den 6. Klassen beteiligten sich 14 Schülerinnen und Schüler, aus den 7. Klassen sogar 20.

Der Jury gehörten neben den drei Deutschlehrern Prof. Stierle, P. Happel SJ und Herr Schierschke, ehemaliger Auslandsschulleiter, von der Hertiestiftung an.

Die ermittelten Gewinner erhielten am 13. Mai in einer kleinen Feier vom deutschen Geschäftsträger im Kosovo, Herrn Wollfarth, und dem Fachberater Deutsch für Kosovo, Montenegro und Makedonien, Herrn Dr. Rabitsch, ihre Urkunden und ein Buchgeschenk.

Der Spaß der Kinder am Wettbewerb und ihr Fleiß bei der Vorbereitung und die Qualität der Vorträge machen uns Mut, nächstes Schuljahr den 2. Vorlesewettbewerb zu veranstalten!

Allen Gewinner gratulieren wir nochmals, den Mitgliedern der Jury, insbesondere Herrn Wollfarth und Herrn Dr. Rabitsch sei nochmals ganz herzlich gedankt!

## Aktiviteti

### Gara e parë në lexim të zëshëm Ndarja e çmimeve

Leximi rrezikon marrëzinë!

**"Të gjithë dëgjoni këtu! Ne, po lexojmë me zë!"**

Në një Evropë që gjithnjë e më tepër bashkohet dhe në botën e globalizuar, njohuritë e mira të gjuhëve të huaja, fitojnë për të rinjtë domethënie të jashtëzakonshme. Me këtë rast, leximi si në gjuhën amtare, ashtu edhe në gjuhët e huaja është një kualifikim kyç.

Në qoftë se arrihet që me mbështetjen shkollore të zgjohet kënaqësia e leximit, nxitjen e leximit dhe leximit t'i krijohet një vend i qëndrueshëm në jetën e përditshme të fëmijëve dhe të rinjve, atëherë edhe kompetenca e leximit zhvillohet më tutje. Ai që lexon shumë, mëson shumë, njohuritë e reja nga leximi mund ti lidh me njohuritë ekzistuese dhe këto t'i këmbëjë me të tjerët.

Më 27 prill 2006, "Loyola-Gymnasium", organizoi për herë të parë garë në të lexuar me zë nga gjuha gjermane. Me këtë rast, nxënësit e klasës së 6 dhe 7, lexuan tekste të përgatitura paraprakisht dhe tekste të panjohura.

Kriteret e vlerësimit, ishin: Ndarje përmes rënies së tonit dhe pushimet, vokalet, konsonantet, theksi, intonacioni, rrjedhshmëria dhe shpejtësia e të folurit. Nga klasa e 6, morën pjesë 14 nxënëse dhe nxënës, nga klasa e 7 mardje 20.

Në juri, ishin pranë njëri-tjetrit tre mësimehënës gjermanë, Prof. Stierle, P. Happel SJ dhe zotëri Schierschke, drejtor i dikurshëm i shkollës jashtë vendit, nga Fondacioni Hertie.

Më 13 maj, në një kremtim të vogël, Shefi i Zyrës Gjermane në Kosovë, zotëri Wollfarth dhe këshilltari profesional për gjuhë gjermane për Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni, zotëri Dr. Rabitsch, ua ndanë fituesve të zgjedhur çertifikatat dhe librat e dhuruara.

Argëtimi i fëmijëve në garë dhe zelli i tyre gjatë përgatitjes, si dhe cilësia e paraqitjes së tyre, na japin zemër që vitin e ardhshëm ta organizojmë garën e dytë në lexim të zëshëm.

Të gjithë fituesve, ne ju urojmë edhe një herë, edhe anëtarëve të jurisë, veçanërisht zotëri Wollfarthit dhe zotëri, Dr. Rabitsch. Ju falënderojmë edhe një herë, me tërë zemër!



## Veranstaltung

## Aktiviteti

### Wettbewerb der Künste

### Gara në artin figurativ

#### RAPORT

për pjesëmarrjen në takimim e zhvilluar në Bibliotekën Ndërkomunale

Prizren, më 12.05.2006, në orën 12:00

Me ftesë për Gjimnazin "Loyola", nga drejtoresha e Bibliotekës Ndërkomunale në Prizren, znj. Sahadete Sadikaj, mora pjesë në mbledhjen, ku ishin ftuar përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme të Prizrenit. Ashtu si ishim informuar me shkresën e drejtoreshës së bibliotekës, në mbledhje, morëm njohtimin për organizimin e aktiviteteve garuese artistike-letrare për nder të Ditës së çlirimit të Prizrenit dhe të përvjetorit të Lidhjes së Prizrenit.

Këto aktivitete, sponzorohen nga MASHT-i dhe kanë karakter garues. Në to mund të marrin pjesë nxënësit e të gjitha shkollave.

Konkurohet për këto aktivitete: Recitim, Poezi, Prozë dhe Art figurativ.

Është në interes të shkollës që edhe nxënësit tanë të marrin pjesë në këto aktivitete. Ata janë të përgatitur që të konkurojnë në të katër aktivitetet e përmendura. Ju bëj me dije, se unë jam zgjedhur anëtar jurie për vlerësimin e punimeve të nxënësve.

Kërkoj pëlqimin tuaj për pjesëmarrjen e nxënësve tanë në këto aktivitete.



## Veranstaltung

## Aktiviteti

### Teilnehmer

### Pjesë marrësit

Drejtuar:

BIBLIOTEKËS NDËRKOMUNALE PRIZREN

Znj. Sadete Sadikaj–drejtoreshë dhe Komisionit (Jurisë)

LËNDA:

Njohtim për pjesëmarrjen e nxënësve tanë në aktivitetin letrar–artistik për nder të festave të qershorit.

Kam nderin t'ju bëj me dije, se e kemi pranuar me kënaqësi njohtimin tuaj për shpalljen e garave për nderë të festave të qershorit dhe me kënaqësi, ju njohtojmë, se edhe nxënësit tanë do të marrin pjesë në këtë aktivitet.

Nxënësit e shkollës sonë, do të konkurojnë me këtë radhë:

**Për art figurativ:**      **Për poezi:**

Nashid Karjagdiu, VII b, mozaik

Alisë Hasani, VII a

Vlorë Duraku, VII b, grafikë

Lorzë Gashi, VII b

Kristianë Çuni, VII c, pikturë

Agim Margilaj, VI a

Arditë Gjoni, VII b, grafikë

Yllkë Meqa, VII c

Kristianë Çuni, VII c, akualet

Rritë Temaj, VII c

Lorikë Bytyqi, VI a, grafikë

Dardan Suka, VI c, aplikative

**Për recitim:**      **Për prozë:**

Teutë Nafëzi, VII c

Alisë Hasani, VII a

Artë Bytyqi, VII a

Rritë Temaj, VII c

Yllkë Meqa, VII c

Lorzë Gashi, VII b

Ju falënderojmë për ftesën dhe ju dëshirojmë suksese në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm!

Dritë Kabashi, prof.

Skender Berisha, prof.

## Veranstaltung

## Aktiviteti

### Preisträger

### Fituesit

Lënda:

Raport për pjesëmarrjen e nxënësve tanë në aktivitetet letrare e artistike nën organizimin e Bibliotekës ndërkomunale në Prizren

I nderuar, Z. Happel, prej datës 1 qershor 2006, nxënësit tanë kanë marrë pjesë në garat e shpallura në nivel të komunës, e për nder të Ditës së çlirimit të Prizrenit dhe 128 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me punimet e veta, gjimnazin "Loyola", e kanë përfaqësuar nxënësit tanë më të mirë. Punimet e tyre, janë zgjedhur nga profesorët tanë: Dritë Kabashi, Tringë Veseli dhe Skënder Berisha.

Nxënësit fitues në këto aktivitete, janë:

1. Lorzë Gashi ( prozë ) – "Marshi i jetës" – VENDI I PARË
2. Kristiana Çuni ( pikturë ) – VENDI I DYTË
3. Rritë Temaj ( prozë ) – "Më kujtohet" – VENDI I TRETË
4. Alisë Hasani ( prozë ) – "Do të vijnë edhe për mua çaste të gëzuara" – VENDI I TRETË
5. Agim Margilaj ( poezi ) – "Miku" – VENDI I TRETË.

Ju bëj me dije se, shpërblimet për fituesit, do të ndahen më

9 qershor 2006.

Prof.Skender Berisha



## Veranstaltung

## Aktiviteti

Im Rhythmus des Lebens  
Lorza Gashi VIII b

Marshi i jetës



Nata ishte e qetë, me hënë që rrezatonte aq shumë sa s'ka. Ajo, sikur nuk donte të dinte, për ata lotë, për atë vaj e pikëllim. Duhej të fillonim "marshin e jetës", ku me mijëra njerëz jetonin në ankthin: jetë a vdekje!

U ndamë prej kësaj mase të madhe njerëzish, duke marrë inkurajimin dhe uratën, që vdekja mos ta ndërpriste rrugën e marshit të jetës, që po nisnim. Mendje, zemër e sy, kishim drejtuar, matanë Alpeve shqiptare, ku prisnin mijëra të tjerë, zemërndarë, gjysmën andej e gjysmën këndej kufirit të gjakosur. Në atë natë plot frikë e ankth, i kujtoj përshëndetjet e ndrojtura që i ngjanin psherëtimave të dalura nga buzët e thara, të cilat lageshin nga lotët, që rrëshqisnin heshturazi.

Erdhën katër ushtarë të armatosur, për t'na përcjellur, ndoshta vetëm sa ta kalonim Luginën e Vdekjes-vendin në të cilin korbat e zi hanë mishin e fatit tonë. U ndamë në vendin e caktuar, duke i belbëzuar lamtumirën njëri-tjetrit, e duke ndrydhur në shpirt shpresën se një takim i sërishëm do të ndodhë. U dëgjua, midis psherëtimave, se ndoshta do të takohemi një ditë në dasmën e madhe të Kosovës. Mu duk se dikush, mori guximin, t'na jap ftesën për këtë dasëm. Më vonë mora vesh dhe e pashë, se kjo ftesë ishte një shami e vogël dhe e kuqe, që ia kishin lidhur rreth qafe një vajze të vogël-trivjeçare, e cila qeshte sikur po e ndiente erën e lirisë dhe po bëhej një grishëse e saj. Më bëhej sikur, mbrenda buzëqeshjes së saj po vetëdijonte vet liria.

Ecëm e ecëm, pa u ndalur. Dikur vonë, hëna na tradhëtoi. Ah! Ishte e tmerrshme. Na u thyje shpresa për të vazhduar marshin e jetës.

Ditën tjetër, dielli u tregua besnik, duke na ftuar me rrezet e tij të ngrohta. Kufiri ishte afër. Kishim vetëm edhe pakëz udhë deri te kufiri. Kishim edhe pakëz shpresë se do ta mbaronim këtë marsh të gjatë.

Më në fund arritëm. Arritëm duke qarë, na pritën duke qarë, na përqafuluan me të qara dhe hëngrëm e pimë duke qarë. Nuk e di a fjetëm a jo, por e di se ëndërruam edhe një herë, se një ditë do të kthehemi në vatrat tona.

## Veranstaltung

## Aktiviteti

Ich erinnere mich . . .

Rrita Temaj VII c

Më kujtohet . . .



Nuk mund ta kujtoj, pa u rrëqethur, ditën e një tmerri të madh të jetës sime dhe të brezit tim të tmerruar. Ajo ditë ishte e tmerrshme. Erdhi me një erë të forte e rrënuese. Na i rrënoi shtëpitë, na i prishi të lashtat dhe hapi shumë varre.

Kjo erë e çmendur, mori me vete gjithëçka që gjeti: pleq, të rinj e foshnja.

Unë, isha fëmijë. Ene nuk kisha filluar klasën e parë. Nuk dija të mendoja as të lutesha. Edhe njerëzit tjerë s'patën kohë të luteshin që të ndalej ajo erë e tmerrshme, që fërsëllente nga të gjitha anët. Ajo sikur donte t'na fshinte nga faqja e dheut. Më dhimbsej shtëpia, më dhimbsej vendlindja, por nuk dija të frikësohesha për veten. Nuk e dija, as s'mund të dija se ç'mund të më ndodhte mua !

Luftohej për të jetuar Kosova, luftohej për t'u mbjellur të lashtat e pambjellura, luftohej për të pasur zjarr në vatër, luftohej për të pasur përherë cicërrima fëmijësh, luftohej për shkronja shqipe në fletoret e fëmijëve. Po, unë nuk arrija ta kuptoj këtë. Mua s'më linte kjo erë e tmerrshme, s'më linte të kuptoja asgjë.

Plaku që ishte ulur në një kënd të oborrit, ishte gjyshi im. As praninë e tij të sigurtë, atë ditë, nuk arrija ta besoja.

Ai merrte frymë shpesh e thellë dhe shikimi i tij, ishte tretur në largësi. Dikur, psherëtiu sikur të kishte bërë një rrugë të gjatë e të mundimshme dhe në fund, ta kishin lëshuar këmbët. Iu afrova dhe nisa ta shikoja si asnjëherë tjetër. Ma kapi dorën e më tha: "Jetë, o jetë!" – dhe humbi në mendime. I dukej se një mjegull ia kishte zënë gjithë hapësirën dhe ia kishte ndrydhur shikimin. Sytë, i lëshuan lotë. Pas pak psherëtiu edhe një herë, e tha: "Ta lësh vendin tënd, vendin ku ke lindur dhe je plakur. Ah! Qenka vështirë, bre!".

Plaku heshti. Ndoshta në këto çaste, kujtonte shpejt të kaluarën e tij. Këtë heshtje, shpejt ia prishi zhurma e kolonës, që nisi të lëvizë, drejt të panjohurës. Edhe ne, duhej të niseshim. Kjo, sikur e zgjoi plakun dhe e shkundi nga ai mendim i thellë. Kësaj radhe, fjalët e tij, u dë-gjuan edhe më larg: "Oh, breee! Shtëpitëkemi pasur të forta dhe prej guri, që të mbroheshim nga plumbat, po këtë nuk e kemi kujtuar!". Pas këtyre fjalëve, hyri në automobil e po shikonte përjashta.

Kolona e automobilëve, traktorëve, qerreve;po lëvizte ngadalë. Askush, nuk e dinte se ku do të ndale-shin. Plaku, nuk u ndie më. Dëgjonim, vetëm ushtimën e motorëve të automobilëve, tankeve, a të ndonjë aeroplani luftarak që fluturonte qiellit të Kosovës. As zogj nuk shihnim. Sikur ishin fshehur dikund. Athua, do t'na presin zogjtë ndonjëherë!

Mësimi i gjermanishtes, në "Loyola-Gymnasium", gjeti grupin e përkrahësve të vet menjëherë, që me fillimin e vitit shkollor. Midis 184 nxënësve, kishte mjaft prej atyre që kishin pasur kontakte me gjermanishten e folur dhe të shkruar. Disa prej tyre, kishin lindur në dhe kishin vijuar mësimet në Gjermani ose në Zvicër apo në Austri. Edhe ata që nuk kishin parnjohuri në gjermanisht, më vonë, nisën të hyjnë në rend dhe t'i zënë njohuritë e para, nga të cilat pastaj u joshën dhe nisën të tregohen gjithnjë e më kureshtarë.

Për të kapërcyer vështësitë e para të mëimit të gjermanishtes dhe për të pasur mundësi të korigjohet diçka, dy arsimtarët e gjermanishtes, Adelinë Jakupi dhe Neki Jahaj, gjat pushimit dimëror, ishin në një vizitë Gjimnazit në Nordrhein-Westfalen. Edhe ardhja e arsimtares Tanja Becker, në shkurt të vitit 2006, ndikoi në konsolidimin e mëimit të gjermanishtes.

Pas një kohe të shkurtër, gjat muajit mars, arsimtarët e gjermanishtes, hapën fillimin e garës në lexim të tekstit, për të parë, pas notave të gjysmëvjetorit edhe përparimin real të nxënësve në të lexuar (Vorlesewettbewerb). Kjo garë, u mbajt më 27 prill 2006. Nxënësit që morrën pjesë në këtë garë, kishin për detyrë të lexonin para komisionit, një tekst të njohur dhe një tjetër të panjohur të përcaktuar nga komisioni.

Rezultatet e këtij konkursi në lexim, u shpallën solemnisht më 13 maj 2006, në praninë e z. Dr. Rabitsch-përgjegjës për mësim të gjermanishtes, në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni si dhe shefit të Zyrës së Gjermanisë në Kosovë – z. Wollfarth.

Nxënësve fitues, iu dhanë mirënjohje dhe dhurata. Fituesit e garës së leximit për klasat e gjashta dhe të shtata, dolën:

1. Pëllumb Ivezaj, kl. VI a-vendi i parë
2. Florinë Kabashi, kl. VI a-vendi i dytë
3. Muhamet Shala, kl. VI a-vendi i tretë

Për klasat e shtata, renditja e nxënësve fitues, është kjo:

1. Anetë Nurkollari, kl. VII c-vendi i parë
2. Leutrim Isufi, kl. VII b-vendi i dytë
3. Kastriot Thaçi, kl. VII a-vendi i tretë

Është mjaft e rëndësishme të përmendet edhe fakti se, disa nga nxënësit e shpërblyer, me rastin e solemniteteve në shkollë, i shërbyen shkollës dhe drejtuesve të saj në rrolin e përkthyesve mjaft të suksesshëm. Në rrol të tillë, u paraqitën një numër e-dhe më i madh i nxënësve, në Ditën e derve të hapura, më 29 prill 2006.



## Fortbildung

Hospitation in Nurfringen  
Adelina Jakupi

## Rrjedha e mëtejme

Hospitim në shkollë të  
Nurfringenit



Si mësimdhënëse e gjuhës gjermane në "Loyola-Gymnasium", pata edhe unë mundësinë të marr pjesë në një trajnim (hospitim), në Gjermani. Ishta për tri javë, në shkollën "Grund und Hauptschule mit Werkrealschule", në Nufringen. Ishte një shkollë ku mësimet i vijonin nxënësit prej klasës së parë deri në klasën e nëntë fillore. Kjo shkollë, kishte gjithsej 354 nxënës dhe 26 mësimdhënës. Ishte shkolla e vetme në atë vend, pasi që Nufringeni ishte një vend shumë i vogël edhe numri i nxënësve ishte relativisht i vogël.

Gjatë këtyre tri javëve, pata mundësinë t'i vizitoj të gjitha klasat, prej atyre më të vegjëlve e deri ata të klasave të larta. Pasi që në atë shkollë mësohej gjuha angleze prej klasës së parë, ishin shumë interesante metodat të cilat mësimdhënësit i përdorënin.

Kryesisht, kam marrë pjesë në orët e mësimet të gjuhës gjermane dhe asaj angleze. Dy javët e fundit, i kam kaluar me klasën e pestë. Gjatë kësaj kohe, u njoha me metoda të ndryshme të mësimdhëniës. Poashtu, m'u dha mundësia të marr pjesë në përgatitjen e një provimi me shkrim në gjuhën angleze. Përshtypje të veçantë më ka lënë bashkëpunimi i nxënësve mes veti dhe ndihma të cilën ata mundoheshin t'i ofrojnë njëri – tjetrit, poashtu edhe disiplina dhe angazhimi gjat orëve të mësimet. Po ashtu edhe bashkëpunimi i mësimdhënësve ishte në nivel.



## Romreise

Audienzen beim Papst  
P. W. Happel SJ

## Udhëtimi në Romë

Audiençë te Papa

Im Januar 2005 besuchte P. Happel Papst Johannes Paul II.

Im Januar 2006 war P. Happel wieder in Rom und besuchte dessen Nachfolger, Papst Benedikt XVI.

Beiden Päpsten überreichte er Informationsmaterial zum Loyola-Gymnasium.



Papst Johannes Paul II im Januar 2005



Papst Benedikt XVI im Januar 2006

Schule

Shkollë

Albanisch

Gjuhë shqipe

Në kuadër të punëve në lëndën e Gjuhës shqipe dhe të letërsisë, arsimtarët, gjatë gjithë vitit shkollor, kanë punuar në nxitjen e punës krijuese të pavarur të nxënësve, duke e mbajtur një frymë gare të vazhdueshme letraro-artistike, e cila dha frytet e saj sepse nxënësit, nisën t'i tregojnë afinitetet e tyre në gjini të ndryshme letrare. Kjo u vërejt edhe me rastin e shfaqjes së programeve kulturore e artistike, në ditë të shënuara.

Në lë lëndën e Gjuhës shqipe e të letërsisë, gjatë vitit shkollor 2005/6, u dalluan nxënësit:

- Alisë Hasani,
- Rritë Temaj,
- Arianit Hazrolli,
- Lorzë Gashi,
- Enxhi Susuri,
- Teutë Nafezi,
- Agim Margilaj,
- Kurbinë Çollaku,
- Riolë Gashi,
- Fiorentinë Sahiti,
- Agron Suka,
- Donikë Berisha,
- Kristian Oroshi,
- Gresë Kabashi,
- Drilon Bytyqi,
- Brisildë Kabashi,
- Leutrim Kabashi e
- Andrra Sylqe.



## Schule

## Shkollë

### Latein

### Gjuhë latine

Edhe pse lënda e Gjuhës latine, për nxënësit e ardhur në Gjimnazin "Loyola", ishte plotësisht e panjohur dhe ata nuk kishin njohuri paraprake, në sajë të përpjekjeve të vazhdueshme të dy arsimtarëve me përvojë dhe këmëngulësisë së nxënësve, u arrit të kapërcehen vështërsitë dhe të arrihen rezultate të mira.

Në sajë të mundit të pakursyer, nxënësit arritën të zotërojnë leximin, shkrimin e përkthimin në gjuhën latine. Njohuritë e raja në një lëndë të re, u bënë shpejt atraktive dhe interesante. Tash mësimi dhe njohuritë e reja, merreshin më me dëshirë dhe më lehtë.

Arsimtarët e lëndës së Gjuhës latine, Ramadan Ramadani dhe Zef Lleshdedaj, përgjatë vitit shkollor 2005/6, veçuan si të dalluar, këta nxënës:

- KurbinëÇollaku,
- Brisildë Kastrati,
- Vionë Maloku,
- Gresë Kabashi,
- Kristian Oroshi,
- Rritë Temaj,
- Enxhi Susuri,
- Agron Suka,
- Safete Bytyqi,
- Pëllumb Ivezaj,
- Albulenë Bajraktari,
- Vlorë Duraku,
- Yllkë Ivezaj,
- Enxhi Susuri,
- Arianit Hazrolli,
- Egzonë Ajazaj,
- Doruntinë Spaçi,
- Donjetë Spaçi,
- Leutrim Isufi,
- Drilon Bytyqi,
- Agonë Shporta,
- Elze Skenderi e. t. j.



## Schule

### Kunst, Sport und Musik

## Shkollë

### Art figurativ, edukatë fizike dhe art muzikor

Mësimin në lëndën e Artit figurativ, e zhvilloi arsimtarja Tringë Veseli. Ajo, arriti shumë shpejtë që t'i zbulojë afinitetet dhe prirjet e nxënësve të të gjashtë klasave për art. Pothuaj, gjatë gjithë vitit shkollor, të organizojë ekspozita punimesh arti, të cilat me ndihmën e nxënësve i ekspozonte në holin e shkollës. Ekspozitat e tilla, bëheshin me rastin e festave dhe në ditë të shënuara të shkollës. Ato e nxitën frymën e garës midis nxënësve dhe zgjuan kureshtjen e vizitorëve të shkollës si dhe u ranë sy edhe vet prindërve.

Në këto ekspozita dhe në mësimin e rregullt, me zellin në mësim e në punën praktike, u dalluan këta nxënës:

- Nashid Karjagdiu, kl. VII b (mozaik),
- Vlorë Duraku, VII b (grafikë),
- KristianëÇuni, kl. VII c (pikturë),
- Arditë Gjoni, kl. VII b (grafikë),
- Kristianë Çuni, kl. VII c (akualet),
- Lorikë Bytyqi, kl. VI a (grafikë),
- Dardan Suka, kl. VI c (art aplikativ) e. t. j.



## Schule

## Shkollë

**Mathematik, Biologie, Physik,  
Erdkunde und Geschichte**

**Matematikë, biologji, fizië,  
gjeografi dhe histori**

Lëndën e matematikës, në Gjimnazin "Loyola" me klasat e gjashta dhe të shtata e mbajtën arsimtarët, Halit Buzhala dhe Ismet Temaj. Ata, pas matjeve të para të paranjohurve të nxënësve, evidentuan mangësitë e tyre dhe përgatitën metoda adekuate mësimi për t'i tejkaluar këto mangësi. Me fjalë tjera, njohuritë paraprake të nxënësve në lëndën e matematikës e veçanërisht në gjeometri, ishin mjaft modeste. Për këto arsye, arsimtarëve iu desht që të angazhohen shumë më tepër në punë, për t'u shmangur mangësitë e evidentuara. Arsimtarët e matematikës, gjat punës, kanë ndier edhe mungesën e mjeteve adekuate të mësimore për lëndën e matematikës.

Përgjatë gjithë vitit shkollor, në mësimet e lëndës së matematikës, janë dalluar këta nxënës:

- Agim Xhoxhaj,
- Fiorentinë Sahitaj,
- Meriton Tuli,
- Kurbinë Çollaku,
- Doruntinë Spaçi,
- Rritë Tamaj,
- Aulonë Vezgishi,
- Gresë Kabashi,
- Kristian Oroshi,
- Donikë Berisha,
- Alisë Hasani,
- Arbias Zeqiri,
- Arianit Hazrolli,
- Brisildë Kastrati,
- Leutrim Jusufi e. t. j.



Duhet përmendur faktin se, shumica e nxënësve të dalluar në lëndën e matematikës, kanë dalur shumë të sukseshëm edhe në lëndët tjera.

Mësimin e biologjisë për të gjitha klasat e shkollës, e ka bërë, z. Ruzhdi Kuqi. Ai që nga fillimi, ka gjetur dhe është mbështetur shumë në resurset natyrore (ambientale), që ka rrethi i Prizrenit, në llojet e bimësisë. Kjo gjë, u ka mundësuar nxënësve që të mësojnë, t'i dallojnë konkretisht llojet e bimësisë që ka ambienti ynë. Shumë shpesh, e kemi vërejtur arsimtarin e biologjisë, të ketë sjellur me veti, rrënjë bimësh të ndryshme, gjethe, lule e. t. j., për t'ua konkretizuar sa më shumë mësimin nxënësve. Ai ka shfrytëzuar edhe mjetet ekzistuese teknike të konkretizimit që kishte në dispozicion shkolla.

Mësimin e lëndës së Fizikës, e ka mbajtur, arsimtari Ismet Temaj, ndërsa mësimin në lëndët: Gjeografi dhe Histori, e kanë mbajtur arsimtarët, Halit Buzhala, Neki Jahaj, Zef Lleshdedaj, Ramadan Ramadani, Neki Jahaj dhe Skender Berisha.



## Schule

### Fremdsprachen

## Shkollë

### Mësimi i gjuhëve

Në Gjmnazin "Loyola", mësimi të gjuhëve i kushtohet rëndësi e madhe. Mësimi mbahet në gjuhën shqipe–gjuhë amtare. Gjuhët tjera, si gjermanishtja, latinishtja e anglishtja, trajtohen si të rëndësishë së veçantë. Gjatë vitit shkollor 2005/6, mësimin e gjuhëve e bënë arsimtarët: Shpresë Kabashi dhe Skender Berisha (Gjuhë shqipe), Adelinë Jakupi e Neki Jahaj (Gjuhë gjermane), prej muajit shkurt 2006, atyre iu bashkua edhe z. Tanja Becker që erdhi nga Gjermania, Zef Lleshdedaj dhe Ramadan Ramadani e udhëhoqën mësimin e latinishtes, ndërsa mësimin e anglishtes e bëri prof. Mark Gojani. Të gjithë arsimtarët kishin përgatitje adekuate profesionale për zhvillimin e mësimi në këto lëndë.

Përveç kësaj, ata edhe paraprakisht ishin të njohur mes veti, gjë e cila u mundësoi që gjatë vitit shkollor të kenë bashkëpunim të ngushtë dhe frymë kolegjialiteti. Ky bashkëpunim është vërejtur në hartimin e planeve të punës, në ngritjen e nivelit të punës me nxënës, në aktivitetet e lira të cilat janë organizuar në shkollë me rastin e festave dhe ditëve tjera të shënuara.



Lëndën e Artit muzikor, në fillimvjetin e parë shkollor në Gjimnazin "Loyola", e kanë zhvilluar arsimtaret, Shpresë Kabashi dhe Tringë Veseli. Ato, në gjashtë klasat, kanë zhvilluar teorinë e muzikës. Shumë shpejt, kanë pikasur cilësitë vokale të nxënësve dhe me ndihmën Luçie Çollakut, kanë arritur t'i parapërgatitin për t'i inkuadruar në korin e shkollës. Ky kor, i formuar jo pa mundime, u paraqit për të parën herë, në programin kulor të përgatitur për nder të festës së 28 Nëntorit dhe u pëlqye mjaft nga prindër e arsimtarë. Më vonë, gjat vitit shkollor, kori pati edhe paraqitje tjera të cilat edhe më shumë nxorrën në shesh cilësitë e tij. Kori, në paraqitjet e veta, kishte në repertoar, këngë korale shqiptare dhe të traditës evropiane.

Nxënësit më të dalluar në muzikë, ishin:

- Drilon Bytyqi,
- Enxhi Susuri,
- Liridonë Gjokaj,
- Brigitë Dani,
- Alisë Hasani,
- Albë Elshani,
- Besart Bllaca,
- Brisildë Kabashi,
- Dea Ukimeri,
- Fiorentinë Sahiti,
- Dianë Çeta,
- Lis Nuhaj,
- Petrit Hoxhaj,
- Andrra Sylqe e. t. j.



## Schule

### Sport

## Shkollë

### Sport

Edhe pse me fillimin e vitit të parë shkollor, Gjimnazi "Loyola", nuk kishte infrastrukturë të gatshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive, arsimtari i lëndës së Edukatës fizike, Mentor Ukimeri, shfrytëzoi të gjitha mundësitë objektive edhe jasht shkollës, për të realizuar orët dhe për të arritur objektivat që shtronte planprogrami mësimorë.

Në gjysmëvjetorin e parë, u shfrytëzuan dy klasë më të mëdha, në të cilat me nxënësit u punua më shumë në ushtrime trupo-re-fitness dhe ping-pong, për ç'gjë ishin në dispozicion tavolinat. Gjat gjithë vitit shkollor, rreth 80% e nxënësve, e kanë zotëruar lojën e tenisit.

Garat e para sportive në shkollë, janë mbajtur në ping-pong, për nder të festës së 28 Nëntorit. Gara zgjoi interesim të madh dhe në të morën pjesë 70 nxënës. Fitues të garës, dolën: Agonë Shporta – e para, në konkurrencën e vajzave dhe Luan Musa – i pari, në konkurrencën e djemve.

Më 9 janar 2006, me arsimtarin e tyre, udhëtuan për në Brezovicë (shtatë ditë), për një kurs skijimi. Nxënësit, atje, kryen kursin e fazes I, II dhe III (33 veta). Gjatë qëndrimit shtatë ditorë në Brezovicë, nxënësit tanë, kanë marrë mirënjohje për sjellje të mira, nga stafi udhëheqës i motelit "Molika", Nxënësit më të suksesshëm në këtë kurs skijimi, janë treguar:

- Besart Bytyqi,
- Leutrim Isufi,
- Dardan Shabani,
- Alisë Hasani,
- Haris Avdiqi dhe
- Agonë Shporta.

Gjatë muajit qershor, u mbajtën një turne futbollit dhe një garë noti, të dyja të organizuara për nder të 12 Qershorit-Ditës së çlirimit të qytetit të Prizrenit dhe Kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kampion i garës në futboll, doli klasa VII b, e cila edhe fitoi kupën kalimtare. Në garën e notit, që u mbajt në pishinën "Isa Petroll", në disiplinën krol, fitues dolën: Alisë Hasani – e para, në konkurrencën e vajzave dhe Haris Avdiqi – i pari, në konkurrencën e djemve.



## Hospitation am Kolleg St. Blasien Ramadan Ramadani, Zef Lleshdedaj

## Hospitim në Kolleg St. Blasien



Këmbimi i përvojave vërtetë ndihmon. Se përvoja mëson, tregon proverbi latin: *Experientia est omnium rerum magistra*. Qëndrimi trijavor prej 25.03.2006 deri më 15.04.2006, në **Kolegjin St. Blasien**, pati ndikim në ne. Në shikim të parë, na u duk si një objekt i madh, më pastaj vërejtëm po- ashtu se aty bëhet edhe punë e madhe.

Mirëpritja nga ana e personelit mësimor, vizita e klasave, zyreve, sallës së mësimdhënësve, dhomave të konviktit, mbolli në ne përshtypjen e përvojës së punës të Kolegjit të njohur St. Blasien. Populli thotë: **Dita e mirë shihet në mëngjes**. Ne që nga dita e parë, me rastin e njohjes me profesorët e gjuhës latine e të tjerët, vërejtëm mbarëvajtjen e punës së tyre. Mësimdhënësit dhe nxënësit ishin të përpiktë në punë. Prandaj, aty, në atë gjigant të mësimit nuk mund të mungojnë rezultatet e punës. Edhe përkundër numrit të madh të nxënësve mbizotëronte disiplinë e papërshkrueshme. Në klasë ta ka ëndja t'i dëgjosh përgjigjet e nxënësve në gjuhën latine. Vetëm me punë të pandërprerë i kanë arritur ato njohuri për gjuhën latine. Secilën ditë të hospitimit në orët e gjuhës latine, mësonim diçka të re.

Testet, hartimet, përkthimet, analiza e teksteve, përdorimi i fjalorit, metoda e përdorimit të grafoskopit, përsëritjet gjatë orëve të mësimit, na mundësonin të përvetësojmë metoda të ndryshme metodike dhe didaktike, me zbatimin e të cilave nuk mungojnë rezultatet në procesin mësimor. Prania në orën e mësimdhënës, Zonjës Harthkamp, ishte e mirëseardhur. Përvoja, zelli dhe urtia e saj gjatë orës së mësimit i bënte nxënësit për vete, i mbizotëronte. Ishim të mahnitur nga qetësia gjatë orëve të mësimit. Edhe pse pothuaj tri javë ishim të pranishëm në orët e mësimit, vullneti për të qenë të pranishëm, nuk zbehej.

Profesorët thonin se nxënësit të cilët në fillim marrin bazë të fortë të mësimit të latinishtes, në vjetët tjerë, më me lehtësi, do ta përvetësojnë lëndën, dhe nuk do të kenë problem, ngase shumë gjëra përsëriten. Pa i mësuat të lehtë, nuk mbahen mend të tjerat. Me nxënës duhet gjetur shtyllat ku ata mund t'i mbështesin njohuritë e tyre, pastaj mbajnë mend më mirë.

Kërkohet që të angazhohemi me nxënës, dhe sukcesi nuk do të mungojë.

Edhe pse posa kemi filluar, sipas mendimit të atyre që vizituan gjimnazin tonë, janë të kënaqur me mësim, dhe përafërsisht është nivel i njëjtë i njohurive të gjuhës latine në klasat përkatëse.

Ditën e fundit pështypje të madhe na la edhe vizita që i bëmë klasave e kabineteve mjaft moderne. Të shpresojmë se së shpejti do t'i kemi edhe në ALG, në Prizren.

Teksti **Felix**, latinisht- gjermanisht ishte më i kapshëm për nxënësit gjermanë. Me mësimin e gjuhës gjermane edhe nxënësit e gjimnazit tonë, do të kenë më tepër lehtësi në të mësuatit e gjuhës latine.

U ndamë me jehonën e zërit përshëndetës të fillimit të orës së mësimit- **Salvete discipuli! Salve magistra!**

Ishte mësim i mirë për ne, që të vazhdojmë punën në gjimnazin tonë ALG.

Po të mbështetemi në përvojën e tyre edhe neve nuk do të na mungojnë rezultatet e punës. Dhe, në gjimnazin tonë, do të mbjellim një traditë të mbarë të punës dhe procesit mësimor.



## Schule

### Latein Ramadan Ramadani

## Shkollë

### Gjuhë latine

#### Ta mësojmë gjuhën latine

Si të gjitha gjuhët tjera edhe latinishtja e ka zanafillën e vet. Në krahinën **Latium**, Itali, latinishtja përjetoi zhvillimin më të madh, e në mesjetë bëhet gjuhë ndërkombëtare e popujve të Evropës Perendimore, prej nga lindin gjuhët romane, neolatine.

Si gjuhë e përshtatshme, u përhap në shumë vende. Edhe sot, edhe pse asnjë popull nuk e flet, gjuha latine është ruajtur, dhe përdoret shumë në shkencë të ndryshme. Ka shumë fjalë të ngjashme të latinishtes me shqipen, që paraqet lehtësi në mësimin e saj. Nga letërsia romake mësojmë se Eni, Ovidi, Katuli, etj. ishin me origjinë Ilire, që veprimtarinë e tyre e zhvilluan në gjuhën latine.

Shkrimtari Eqrem Çabej thotë: "**Gjuha Latine ka lënë më të thellat gjurmë në shqipen**".

Fjalët e burimit latin janë:

|                    |             |
|--------------------|-------------|
| <b>Schola</b>      | – shkollë   |
| <b>Porta</b>       | – portë     |
| <b>Tabula</b>      | – tabelë    |
| <b>Lego</b>        | – lexoj     |
| <b>Dies</b>        | – ditë      |
| <b>Director</b>    | – drejtor   |
| <b>Res publica</b> | – republikë |

Duke u bazuar në vlerën dhe rëndësinë që ka gjuha latine, mësohet edhe në shkollat tona.

Në ALG, gjuha latine u mirëprit. Mësohet nga klasa e gjashtë. Nxënësjë Aneta thotë: Na patën thënë se latinishtja është gjuhë e vdekur, është e vështirë, e mërzitshme. Por, doli e kundërta, është gjuhë interesante dhe e lehtë. Nxënësit tjerë shprehen se pasi filluam ta mësojmë gjuhën latine, kuptuam se kemi gjetur çelësin e gjuhëve të tjera, se jemi duke mësuar bazën, themelin e gjuhëve tjera. Si dhe mësuam për Trojën, Vezufin, Pompejin, etj..

Nxënësit shkruajtën fjalë të ngjashme të latinishtes me ato të gjuhës sonë shqipe.

Edhe thëniet latine, **Dicta et sententiae**, janë me rëndësi, ku nxënësit mblodhën thënie që ndihmojnë të mësuarit, dhe janë me vlerë për jetën, punën etj. Sa për të rend e vend, po i përmendim thëniet:

|                                            |                                        |
|--------------------------------------------|----------------------------------------|
| <b>Non scholae, sed vitae discimus</b>     | – Nuk mësojmë për shkollë por për jetë |
| <b>Sine lingua Latina non est medicina</b> | – Pa gjuhën latine s'ka mjeksi         |



## Fortbildung

## Rrjedha e mëtejme

### Hospitationen in Deutschland und Österreich

### Vizita pune të arsimtarëve jasht Kosove

Në fundvitin 2005 dhe në fillimvitin 2006, disa nga arsimtarët tanë:

- Adelinë Jakupi dhe
- Neki Jahaj (gjermanisht),
- Zef Lleshdedaj dhe,
- Ramadan Ramadani (latinisht),
- Tringë Veseli (art figurativ),

shkuan për vizitë pune e këmbim përvojash pedagogjike, në Gjermani e Austri. Atje takuan dhe u pritën nga profesorët gjerman, të njohur për ta. Gjatë qëndrimit në këto vende, ata, vizituan shkolla, asistuan në orët e mësimit, u njohtuan me rrjedhat e sistemit arsimor të këtyre vendeve. Neve, nga kjo vizitë na sollën përjetimet e tyre, mikpritjen e përjetuar, përvojat e reja pedagogjike, risitë metodologjike që aplikohen në sistemet arsimore të këtyre dy vendeve.



## Veranstaltung

### Erste-Hilfe-Training



Liebes CIMIC-Center-Team und liebe MEDEVAC Kompanie der deutschen KFOR (13. Einsatzkontingent MNB SW),

im Namen unserer Schülerinnen und Schüler aber auch ganz persönlich nochmals: "Falemindërit shumë - Vielen Dank" für die tolle Unterstützung bei der Organisation und Durchführung des ersten Erste-Hilfe-Trainings am Loyola-Gymnasium. Wir

hätten das alleine so niemals geschafft!

Das war ein klasse Nachmittag, den „unsere Kinder“ sicherlich so schnell nicht vergessen werden. Wir sind zuversichtlich, dass einiges von dem was ihr und wir ihnen gezeigt haben, für den Ernstfall, der hoffentlich trotzdem nicht eintreten wird, in den Köpfen bleibt.

Der krönende Abschluss mit den super Urkunden ist so schnell nicht zu toppen und neben alledem seid ihr den Schülern sympathische Soldaten "zum Anfassen" gewesen. Auch das ist nicht selbstverständlich, hilft aber dem Schrecklichen auch positive Erfahrungen entgegenzusetzen!



Gerne würden wir nächstes Jahr um diese Zeit wieder etwas ähnliches mit den Schülerinnen und Schülern, die dann im Jahrgang 7 sind, durchführen. Vielleicht klappt es ja dann noch einmal auf diese Weise. Wir würden uns freuen wie die Schneekönige.

## Aktiviteti

### Trajnimi i ndihmës së parë




I dashuri Ekip i CIMIC -ut dhe i dashuri MEDEVAC, kompani e KFOR-it Gjerman (Kontingjenti i 13. në shërbim BSHJP),

në emër të nxënësve dhe nxënësve tanë, por edhe krejt personalisht edhe një herë: "Falemindërit shumë - Vielen Dank", për përkrahjen tuaj të mrekullueshme më rastin e organizimit dhe realizimit të trajnimit të ndihmës së

parë (FAT) në Loyola Gymnasium. Ne vetëm këtë nuk do t'ia dilnim ta bënim ashtu!

Kjo ishte një pasdite e veçantë, të cilën "fëmijët tanë", sigurisht, nuk do ta harrojnë për një kohë. Unë jam plotësisht i bindur se disa gjëra të cilat ju dhe ne ua kemi treguar atyre, për rast të ndodhjes së vërtetë, dhe shpresojmë se përkundër saj ato nuk do të ndodhin, do të mbesin në kokat e tyre.

Përfundimi i kurorëzuar me super- certifikatat, nuk do të zbehet shpejt dhe përveç tjerash, ju për nxënësit ishit ushtarë simpatikë "të prekshëm". Edhe kjo, nuk është e vetëkuptueshme. Por ndihmon që të tmerrshmes t'i kundër-vihen përvojat pozitive!



Ne, me ëndje do të realizonim diç të ngjashme, vitin e ardhshëm, në këtë kohë me nxënëset dhe nxënësit të cilët atëherë do të jenë në klasën e shtatë. Ndoshta do të kemi edhe një herë sukses në këtë mënyrë. Ne, do të gëzoheshim si fëmijët.

## Veranstaltung

### Verkehrsunterricht

## Aktiviteti

### Trajnimi për sigurinë në trafik

Am Donnerstag dem 1. Juni besuchte die Polizei die Schule. Nach der letzten Unterrichtsstunde des Vormittags versammelten sich die Schüler um von erfahrenen Polizisten über das richtige Verhalten im Straßenverkehr unterrichtet zu werden. Nach interessierten Nachfragen erhielt jeder Schüler eine Broschüre mit hilfreichen Hinweisen.

Wir möchten uns ganz herzlich bei der Kosovopolizei für dieses Engagement bedanken. Vielleicht kann es ja nächstes Jahr für unsere dann neuen Schüler wiederholt werden.

Të enjten, më 1 Qershor, disa Oficerë policorë, ishin për vizitë në shkollën tonë. Pas orës së fundit mësimore të paradites, nxënësit u grumbulluan të dëgjonin përvojën e Oficerëve të policisë, në lidhje me sjelljen adekuate si pjesëmarrës të trafikut. Pas disa pyetjeve interesante, më vonë, nxënësit morën nga një broshurë e cila përmbante disa njohuri udhëzuese.

Ne, dëshirojmë të falënderojmë Policinë e Kosovës për këtë angazhim dhe përkrahje. Ndoshta, një takim i tillë, për nxënësit tanë që do të vijnë vitin e ardhshëm, do t'mund të mbahet.



## Veranstaltung

### 1. Tag der "Offenen Tür"

Am Samstag, den 29. April, wurde unter reger Anteilnahme der Öffentlichkeit der erste Tag der Offenen Tür veranstaltet. Hunderte kamen, um sich die Schule und das Internat anzusehen.

Einige unterzogen sich einer von Schülern durchgeführten kostenlosen Überprüfung ihrer deutschen Sprachkenntnisse.

Selbst ein Bundeswehrsoldat aus Sachsen bestand den Test zur Verwunderung seiner weniger mutigen Kameraden.

Andere folgten einer Englischstunde zusammen mit den Schülern oder bestaunten die Tabellen mit albanischen Wörtern und deren lateinischen Wurzeln.



Ein Schülerinformationsteam führte durch die Kunstaussstellung, Biologie-, Deutsch- und andere Fachräume sowie das Internat.

Um die Mittagszeit fand die offizielle Begrüßung statt mit kurzen Ansprachen von Vizeminister Berisha, der Vorsitzenden des Elternbeirats, Frau Susuri, und P. Happel SJ, bevor einer unserer Albanischlehrer, Herr Skender Berisha, durch ein buntes Programm mit Musik, Gesang, Gedichtrezitationen und einer kurzen Theateraufführung führte.

Im Hintergrund hatten derweil die Angestellten mit Schülern Getränke und einen Imbiss zur Stärkung aller vorbereitet.

Es war wirklich ein Fest der gesamten Schulgemeinschaft mit vielen interessierten Gästen, die das Angebot gerne wahrnahmen.

## Aktiviteti

### Dita e parë e detyrë të hapura

Të shtunën, më 29 prill, me pjesëmarrje të gjallë të publikut, është organizuar dita e parë e detyrë të hapura. Erdhën qindra vizitorë për të shikuar shkollën dhe konviktin.

Disa prej tyre, iu nënshtruan verifikimit të njohurive të tyre nga gjuha gjermane, të organizuar falas nga nxënësit.

Edhe një ushtar i Bundesverit nga Saksonia, e kaloi testin për habi të shokëve të tij me më pak guxim.

Disa tjerë, morën pjesë në orë të anglishtes së bashku me nxënësit, ose vështronin me admirim tabelat me fjalë shqipe dhe rrënjët e tyre latine.



Një ekip i nxënësve informues, shoqëronte vizitorët nëpër hapësirat e ekspozitës artistike, të kabinetit të biologjisë, atij të gjuhës gjermane si dhe në lokalet e konviktit.

Në mesditë, u zhvillua përshëndetja zyrtare me fjalime të shkurta të zëvendësministrit Berisha, të kryetarit të Këshillit të prindërve, zonjës Susuri dhe P. Happel SJ, para se njëri nga arsimtarët tanë të Gjuhës shqipe, zotëri Berisha të na prezantonte një program të larmishëm me muzikë, këngë, recitim dhe shfaqjen e një pjese të shkurtër teatrale.

Në prapavijë, të punësuarit së bashku me nxënësit, kishin përgatitur pije dhe ushqim të lehtë për freskimin e të gjithëve.

Kjo ishte vërtetë një festë e tërë bashkësisë shkollore me shumë mysafirë tanë, të cilët e pranuan me ëndje ofertën tonë.

## Schule

## Shkollë

### Auszeichnungen

### Të shpërblyerit

Bevor es dann wirklich in die wohlverdienten Ferien ging, wurde natürlich gefeiert und es wurden Preise verliehen. Die jeweils besten Schüler einer Klasse, aber auch jene, die sich durch vorbildliches soziales Verhalten\* ausgezeichnet hatten, wurden geehrt und sollen auch hier noch einmal genannt sein.

Para se të shkonim në pushim, duhej të kremtonim dhe të jepnim shpërblime. Nxënësit më të mire në klasë dhe ata që treguan sjellje të jashtëzakonshme shoqërore\*, u nderuan dhe u shpërblyen dhe do të përmenden përsëri më poshtë.



Bajraktari Albulena VI a



Bytyçi Drilon\* VI a




Çollaku Kurbina VI a



Berisha Donika\* VI b



Kabashi Gresa VI b



Oroshi Kristian VI b



Sahiti Fiorentina VI c



Xhoxhaj Agim\* VI c



Bytyqi Safete\* VII a



Elshani Alba VII a



Hasani Alisa VII a



Hazrolli Arianit VII a



Lezi Albana VII a



Zeqiri Arbias VII a



Jusufi Leutrim VII b



Kastrati Brisilda VII b



Maloku Viona\* VII b



Nafezi Teuta VII c



Nurkollari Aneta\* VII c



Sylqe Andra VII c



Temaj Rrita VII c



Vezishi Aulona VII c

Schule

Shkolla

Klasse VI a  
Schuljahr 2005/6

Klasa VI a  
Viti shkollor 2005/6



Bajraktari, Albulenë  
Bllaca, Albion  
Bytyqi, Drilon  
Bytyqi, Edonjeta  
Bytyqi, Vegim  
Bytyqi, Lorika  
Çetta, Diana  
Çollaku, Kurbina  
Dani, Gjergj  
Dani, Kastriot  
Frrokaj, Gabriell  
Gajraku, Dorentina  
